

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1484
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 11.04.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.45

Datë: 07.04.2023

“Për miratimin e Planit për Emergjencat Civile Bashkia Dibër”

Duke jū falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Adresa: | Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 0035521822935

Kopja
@ksh



1684/1
13/04/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.439/1 prot.

Peshkopi, më 13.04.2023

Lënda: Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË

DIBËR

Në mbështetje të nenit 16-të të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr.45 (dyzetëpesë) datë 07.04.2023, të Këshillit të Bashkisë Dibër, "Për miratimin e Planit të Emergjencave Civile të Bashkisë Dibër", **vendosa:**

Miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr 45 Datë 07/04/2023

“ Për miratimin e Planit për Emergjencat Civile Bashkia Dibër”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1, 2, gërma a dhe c, neni 24, pika 2, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, neni 14, pikat 1, 2, 3 dhe 6, VKM nr. 923 datë 25. 11. 2020 “ Për funksionimin e organizimin e komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile” neni 15, i propozojmë Këshillit Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij si më poshtë vijon, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 07.04.2023 me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

- I. Të miratojë dokumentin e Planit të Mbrojtjes Civile të Bashkisë Dibër.
- II. Plani i Emergjencave Civile ka si qëllim përcaktimin e masave dhe aktiviteteve për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
- III. Pas miratimit të planit të bëhet shpërndarja e tij sipas përcaktimeve ligjore të nenit 8 dhe nenit 14, pika 8 të ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër .
- V. Vendimi u shpall me datë 07.04.2023


Kryetar Këshilli

Sokol Sava

Me urdhër dhe porosi:

Zv. Kryetar i Këshillit Bashkiak

Irimi Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA DIBER
DREJTORIA PPECK

Lënda : Relacion shpjegues në lidhje me përgatitjen e Planit Vendor të Bashkisë Dibër.

Për Këshillin Bashkiak Dibër

Bazuar në **Ligjin Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, neni 14, pikat 1, 2, 3 dhe 6, VKM nr. 923 datë 25. 11. 2020 “ Për funksionimin e organizimin e komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”, nga ana jonë është përgatitur plani vendor për emergjencat civile dhe fatkeqësitë në zbatim të kërkesave të ligjit 45/2019 për përmirësimin, planifikimi, e përdorimit të kapaciteteve, ndarjen e përgjegjësi, identifikimin e boshllëqeve, shmangien e mbivendosjeve dhe menaxhimin efektiv të strukturave shtetërore dhe joshitetërore për përballimin e e emergjencave civile e fatkeqësive.**

PVECF duhet të shihet si një dokument praktik i hartuar nëpërmjet një procesi konsultimesh dhe planifikimi të përbashkët me një numër institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare për ta mbajtur planin koherent dhe të freskuar me informacion të ri në mënyrë të vazhdueshme, aktual e të lidhur të përditësuar me ndryshimet e ambjentit shqiptar, për të arritur qëllimin për të cilin është hartuar për mbrojtjen e popullsisë, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga rreziqet natyrore.

Eshtë e rëndësishme të theksohet se PVECF është një burim praktik i përdorshëm për të gjitha fazat e ciklit të Emergjencave, duke filluar nga *parapërgatitja, përgjigja* e duke vazhduar më tej në fazën e *rikthimit në gjëndjen normale dhe lehtësimin e pasojave*.

Të gjitha pjesët e planit hartohen në mënyrë të vazhdueshme duke reflektuar bashkëpunimin e përhershëm dhe të përditësimeve të reja.

Fuqia e PVECF qëndron në bashkëpunimin dhe konsensusin e të gjitha institucioneve dhe strukturave, për të zvogëluar rreziqet, shpëtuar jetë njerëzore dhe minimizuar dëmtime që vijnë nga fatkeqësitë natyrore.

Rreziku më i madh nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga **tërmetet**, por kohët e fundit evidente janë shfaqur emergjencat dimërore, përmbytjet dhe zjarret në pyje e kullota.

Studimi i vlerësimit të Rreziqeve përmban seksione të përqëndruara në rreziqe të veçanta për dukuritë e mundëshme të rrezikut si:

Tërmetet, përmbytjet, bllokimi nga dëborat, rrëshqitjet e tokës, zjarret në pyje dhe sëmundjet e mundëshme infektive. Vlerësimi i Rreziqeve është një hap mjaft i rëndësishëm që shërben si bazë në procesin e hartimit të PVECF duke siguruar bazën informative në të cilën mund të hartohet një plan më efektiv. Synimi kryesor i këtij studimi është të japë drejtimet bazë për

planifikimin mbi bazën e të dhënave nga e cila mund të ngrihen skenarë të mundshëm për përballimin e Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive si dhe për të patur informacion për dëmet e mundëshme.

Ky është një dokument i cili reflekton eksperiencën për një sërë dukurish të mundëshme rreziku i cili identifikon kapacitetet dhe vështirësitë në përballimin e emergjencave civile në Bashkinë Dibër.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTORI PPECK


Hazbi KAMBERI





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA DIBËR

PLANI VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE DHE
FATKEQËSIVE
(P.V.E.C.F.)
2023



PËRMBAJTJA

1. HYRJE :

**Përditsimi/Rishikimi
Përgjegjësia
Procesi i Planifikimi
Kquadri Ligjor**

2.KONTEKSTI GJEOGRAFIK

3. SKENARËT E RREZIKUT

**Metodologjia
Identifikimi i Riskut
Harta e rrezikut dhe rriskut
Skenarët e Rriskut
Elementët e ekspozuar
Përdorimi i indikatorëve sasiorë**

4. SISTEMI I ALARMIT

**Sistemi shqiptar i lajmërimit të hershëm
Aktivitet monitorues në kohë reale**

4.1.1 Proçedurat e monitorimit

4.2.2 Monitorimi i shkëmbimit të të dhënave

5. MODELI I NDERHYRJES

Organizimi Brenda Prefekturës

Qendra Kordinuese

5.1.5 Zonat e Emergjencës

5.1.3 Mjetet e brendëshme dhe të jashtme

5.5.2 PËRSHKRIMI I MODELIT TË NDERHYRJES

5.2.1 Fluksi i komunikimit

6. FAZAT OPERACIONALE

7. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI ME POPULLATËN

**INFORMACIONI & KOMUNIKIMI
USHTRIME**

8. RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT

9. FJALOR

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME.

Parathënie.

- "Plani Vendor për Emergjencat Civile dhe Fatkeqësive (P.V.E.C.F.) është dokumenti kryesor në Bashki në fushën e Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive".

Në kushtet kur egziston një bazë ligjore, një strukturë në ngritje dhe përmirësim, planifikimi i përdorimit të kapaciteteve, ndarja e mirë e përgjegjësive, identifikimi i boshllëqeve dhe shmangia e mbivendosijeve, është mjaft e nevojshme. Këto kërkesa realizohen nëpërmjet P.V.E.C.F, i cili ofron mundësi për menaxhim efektiv të strukturave shtetërore dhe jo shtetërore për përballimin e Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive.

-P.V.E.C.F. duhet të shihet si një dokument praktik i hartuar nëpërmjet një procesi konsultimesh dhe planifikimi të përbashkët me një numër institucionesh qeveritare dhe jo qeveritare për ta mbajtur planin koherent dhe të freskuar me informacion të ri në mënyrë të vazhdueshme, aktual e të lidhur të përditësuar me ndryshimet e ambientit shqiptar, për të arritur qëllimin për të cilin është hartuar për mbrojtjen e popullsisë, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga rreziqet natyrore.

-Eshtë e rëndësishme të theksohet se P.V.E.C.F, është një burim praktik i përdorshëm për të gjitha fazat e ciklit të Emergjencave, duke filluar nga *parapërgatitja, përgjigja* e duke vazhduar më tej në fazën e *rikthimit në gjëndjen normale dhe lehtësimin e pasojave*.

Të gjitha pjesët e planit hartohen në mënyrë të vazhdueshme duke reflektuar bashkëpunimin e përhershëm dhe të përditësimeve të reja.

-Fuqia e P.V.E.C.F qëndron në bashkëpunimin dhe konsensusin e të gjitha institucioneve dhe strukturave, për të zvogëluar rreziqet, shpëtuar jetë njerëzore dhe minimizuar dëmtime që vijnë nga fatkeqësitë natyrore.

-Rreziku më i madh nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga **tërmetet**, por kohët e fundit evidente janë shfaqur emergjencat dimërore, përmytjet dhe zjarret në pyje e kullota.

-Studimi i vlerësimit të Rreziqeve përmban seksione të përqëndruara në rreziqe të veçanta për dukuritë e mundëshme të rrezikut si:

-*Tërmetet, përmytjet, bllokimi nga dëbora, rrëshqitjet e tokës, zjarret në pyje dhe sëmundjet e mundëshme infektive*. Vlerësimi i Rreziqeve është një hap mjaft i rëndësishëm që shërben si bazë në procesin e hartimit të P.V.E.C.F duke siguruar bazën informative në të cilën mund të hartohet një plan më efektiv. Synimi kryesor i këtij studimi është të japë drejtimet bazë për planifikimin mbi bazën e të dhënave nga e cila mund të ngrihen skenarë të mundshëm për përballimin e Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive si dhe për të patur informacion për dëmet e mundëshme.

-Ky është një dokument i cili reflekton eksperiencën për një sërë dukurish të mundëshme rreziku i cili identifikon kapacitetet dhe vështirësitë në përballimin e emergjencave civile në Bashkinë Dibër.

PËRDITËSIMI/RISHIKIMI

Pas PVEC, planet e emergjencave civile të niveleve dhe strukturave të vetqeverisjes, duhen rishikuar dhe përpunuar që edhe ato të jenë koherente dhe të përshtatshëm. Vazhdimisht do të lindë nevoja e përgatitjes së planeve të reja, siç janë planet e gadishmërisë të cilët hartohen për një ngjarje që ka mundësi të ndodhë në një pikë të afërme dhe të shërbejnë për një periudhë kalimtare deri sa të hartohen planet e emergjencave veçanërisht të aplikueshme.

Hartimi i këtyre planeve fokusohen për rreziqet sezonale ose për ato rreziqe të cilat më parë nuk kanë qenë potenciale, por që mundë të ndodhin.

Plani nuk është përfundimtar, por do të ketë përmirësime të vazhdueshme. në përputhje me ndryshimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm dhe të akteve të ligjore dhe nënligjore.

Përgjegjësia

- **Strukturat e Drejtimit dhe të Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive në nivel qendror në Shqipëri (SDMECF)**

-SDMECF në Shqipëri, përbëhet nga struktura të përherëshme dhe të përkohshme në nivel qendror, në nivel Qarku dhe në nivel Bashkie. Nëpërmjet këtyre strukturave çdo ministri, drejtori ose institucion, aktualisht ka role dhe përgjegjësi të veçanta për të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave. Këto role dhe përgjegjësi ndahen shpesh ndërmjet dy ose më shumë institucioneve. të cilat merren me çështje të tilla, si: furnizimi me ujë, hapjen e kanaleve, ngritjen e mureve mbajtëse, digat ose pritrat, si dhe me çështje të tjera. Për të krijuar një pamje më të qartë dhe për arritjen e një bashkërendimi sa më funksional të roleve dhe të përgjegjësive të këtyre strukturave, ku përfshihen institucione shtetërore dhe joshtetërore.

Këto role dhe përgjegjësi tashmë janë të përfshira në planet specifike ekzistuese për emergjencat civile të hartuara nga këto institucione. Kur këto institucione kanë rol të caktuar në fazën e përgjigjes, pothuajse në të shumtën e rasteve ato do të kenë rol korrespondues në fazat e tjera të ciklit të menaxhimit të emergjencave, duke përfshirë këtu parandalimin dhe lehtësimin.

P.V.E.C.F. është një dokument i rëndësishëm i cili hartohet në mbështetje të ligjit nr.45 datë 18.07.2019” *Për Mbrojtjen Civile*” dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë me Emergjencat Civile duke mbledhur së bashku dhe qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë institucioneve, stukturave shtetërore dhe të shoqërisë civile. Nëpërmjet P.V.E.C.K.synohet:

-Të parandalohet, lehtësohet dhe riaftësohet nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga Emergjencat Civile dhe Fatkeqësive.

-Të sigurohen kushtet për Institucionet shtetërore, publike dhe private për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjëndja normale e jetesës dhe e punës në një situatë Emergjente, me sa më pak humbje, për ruajtjen e rendit, të jetëve njerëzore, të gjësë së gjallë, të pronën, të trashëgiminë kulturore e mjedisit ndaj efekteve të një Emergjence Civile.

-Të garantoher përdorimi i të gjitha burimeve të mundëshme të shtetit, të sigurisë publike, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së Emergjencës dhe lehtësimin e pasojave Nëpërmjet këtij plani krijohen rrugët e komunikimit dhe të shkëmbimit të informacionit të duhur, forcimi i vendimarrjes dhe nëpërmjet bashkërendimit arrihet forcimi i kapaciteteve të përgjigjes në të gjitha fazat e ciklit të Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive.

P.V.E.C.F. është në thelb një mjet bashkërendimi i cili nëse përdoret në mënyrë korrekte do të:

-Shpëtojë jetë njerëzore dhe pasuri.

-Rrisë ndikimin e kapaciteteve ekzistuese.

-Sigurojë mjetet për kërkimin e burimeve ndihmëse shtesë.

-Proçesi i hartimit të P.V.E.C.F, është udhëhequr nga disa parime të cilat do të jenë të njëjta edhe në procesin e zbatimit të tij, Plani është përqëndruar në objektiva të përgjithshme të hartuara dhe të miratuara në mënyrë të qartë.

Të gjitha objektivat specifike në P.V.E.C.F. do të jenë koherente me objektivat e përgjithshme,

-Plani reflekton ligjet dhe vendimet ekzistuese, të cilat në këmbim do ta forcojnë atë.

-Plani përfshin të dhëna, informacion nga të gjitha institucionet në mënyrë të përshtatëshme.

-Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë bazën, shpirtin dhe elementët të cilët prekin planin në tërësi, për të rritur në maksimum ndikimin e të gjitha burimeve të disponueshme si dhe sigurimin e konsensusit.

-Plani inkurajon inisiativa dhe nuk shëndrohet në një instrument ndalues për strukturat dhe njerëzit që duhet të veprojnë.

-Plani do të mbetet një punë në progres, por është një punë mjaftë këmbëngulëse për të qëndruar i përshtatshëm dhe për të qënë në gjëndje të kapërcejë ndryshimet e mjedisit të jashtëm.

-Struktura mbështetëse në Bashki janë:

Drejtoria e Pyjeve të Vetqeverisjes Vendore, Sektorit të Mjedisit dhe Ujrave, Drejtoria Rajonale e Bordit të Kullimit Durrës, OSHEE ,OST, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Zyra Vendore e Arsimit, Autoriteti Rrugor i Rrugëve Shkodër, DSHP, Drejtoria Spitalore, Drejtoria Rajonale e Rezevave Materiale të Shtetit Mat, Grupet vullnetareve, Detashmenti i F.Armatosura Mat, Kryqi Kuq Shqiptar, Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave , OJF-të.

Strukturat e Drejtimit dhe të Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive në nivel të vetqeverisjes vendore.

-Sistemi i Menaxhimit të Emergjencave Civile (SMEC) përbëhet nga struktura të përherëshme, të përkohëshme në nivel qarku dhe në nivel bashkie.

-Në bazë të VKM nr 923 datë 25.11.2020,"Për Funkcionimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional të Institucioneve dhe të Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile", në rastet e emergjencave civile e fatkeqësive", pika 15 në përbërje të strukturës së Prefektit ngrihet dhe funksionon "Sektori i Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile", KMC, komisionet e mbrojtjes civile në nivel qarku e bashkie, të cilët veprojnë nën drejtimin e prefektit të qarkut e kryetarit të bashkisë.

-Ndërsa në bashkitë me qendër qarku, funksionojnë strukturat e KMC si Drejtori e PPMC.

Përgjegjësitë në nivel Qarku.

Në bazë të ligjit nr.45 datë 18.07.2019."Për Mbrojtjen Civile" dhe të ligjit nr.107 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", Prefekti është përgjegjës për drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, nëse çënohen nga faktorë apo proçese fizike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, të cilat rrisin ndjeshmërinë e një individi, komuniteti, pasurie apo rrjeti shërbimesh nga impakteve të rreziqeve.

Në çdo Qark, nën drejtimin e Prefektit, ngrihet një komision i qarkut me detyrë bashkërendimin e veprimtarive të autoriteteve të qarkut dhe të organizatave vullnetare, për menaxhimin e emergjencave civile, kur situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që çënon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësi që sjellin dëme të menjëherëshme e të rënda për jetët njerëzore, gjënë e gjallë, pronën trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

Prefekti ka për detyrë:

-Së pari ka rol parësor në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku, në bashkëpunim me vetqeverisjen vendore për realizimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në qark, si dhe për informimin e publikut e komunitetit të rrezikuar nga fatkeqësitë në lidhje me to.

-Brenda 2 viteve, kryen vlerësimin e rrisqeve në teritorin e qarkut, duke hartuar dhe miratuar

dokumentin e vlerësimit të rrisht nga fatkeqësitë, i cili i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për qëllim analizimi dhe planifikimi :

- Koordinon veprimtarinë e organeve, institucioneve dhe strukturave në nivel qarku, me qëllim zvogëlimin e rrisht nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, të ezaurimit të të gjitha kapaciteteve për menaxhimin e emergjencave civile ose fatkeqësisë, si dhe i kërkon ndihmë për ndërhyrje AKMC-së, në rastet e pamundësisë së menaxhimit të situatës së fatkeqësisë.
- Harton, miraton dhe përditëson Planin për Emergjencat Civile në qark për zbatimin e masave të mbrojtjes civile, si dhe e dërgon AKMC-së, për qëllim analizimi dhe planifikimi.
- Grumbullon dhe përpunon të dhëna të nevojshme nga bashkitë dhe strukturat të tjera të cilat veprojnë në nivel qarku për zvogëlimin e rrisht nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe planizon dhe informon në mënyrë të vazhdueshme për situatën, AKMC-në.
- Siguron funksionimin e sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit në teritorin e qarkut, si dhe informon në kohë komunitetin e rrezikuar, në raste Prefektët e qarqeve fqinje, AKMC-në, për fatkeqësitë që lindin në teritorin e qarkut.
- Merr masat e nevojshme për përgjigjen, përballimin dhe lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë.
- Kërkon dhe ndjek që tek organet vartëse, të funksionojnë, skemat e lajmërimit dhe të funksionimit të tyre.
- Të parashikojë burimet dhe rezervat e nevojshme materiale dhe financiare, për sistemimin e popullsisë në raste emergjence nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë të tjera.
- Të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale.
- Të ndjekë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;
- Të ndjekë riaftësimin nga fatkeqësitë natyre ose nga fatkeqësitë e tjera;
- Të analizojë gjendjen e planizimit të emergjencave civile dhe të njoftojë Departamentin e Planizimit dhe të Mbrojtjes Civile e Fatkeqësive për emergjencat civile që ndodhin në Qark;
- Të paraqesë kërkesë për ndihmë në qarqet fqinje dhe në instancat qendrore kur situatat e emergjencave civile janë përtej mundësive apo kapaciteteve të qarkut, duke kërkuar të shpallet gjendja e emergjencës civile në një pjese ose në të gjithë teritorin e qarkut.
- Të caktojë drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut të tij.
- Monitoron dhe menaxhon situatën emergjente nëpërmjet koordinimit të strukturave qendrore të pranishme në këtë nivel, të cilat janë të përfshira në planin e emergjencave civile të qarkut.
- Thërret komisionin e emergjencave civile në Qark (KECQ)
- Mban regjistër për specialistët në qark, me të cilët ai këshillohet kur gjykohet e nevojshme
- Mban kontakte të vazhdueshme dhe bashkërendon veprimet me QKO (AKMC), me KKECF dhe ZOS në vartësi të situatës dhe me Kryeministrin.

-Këshilli i Qarkut: Është i përfshirë në menaxhimin e E.C. dhe Fatkeqësive, duke bashkëpunuar me Administratën e Prefektit dhe KPPECFQ, si dhe autoritetet e bashkive.

-Në bashkëpunim me strukturat e autoriteteve vendore, Këshilli i Qarkut përcakton vendet për krijimin e vendbanimeve të përkohëshme, magazinat e përkohëshme dhe pikat e shpërndarjes, terrenet për varreza masive dhe nevoja të tjera të mundëshme.

Bashkia : Ka këto përgjegjësi dhe detyra:

-Informon Prefektin për mundësinë e ndodhjes apo ekzistencën e një situatë emergjence në Bashkinë ku ushtron detyrat funksionale.

-Në bashkëpunim me drejtuesit e forcave operacionale, bashkërendon, përgjigjet dhe kërkon ndihmë për ndërhyrje të strukturave të tjera jashtë territorit të Bashkisë/Njësive Administrative ku ushtron detyrat funksionale.

-Raporton Prefektin dhe KPPECFQ në për situatën e emergjencave dhe aktivitetet në përrejt të saj.

Bashkërendon veprimet e forcave që vijnë në ndihmë.

Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive në nivel Bashkie, drejton dhe koordinon aktivitete të dhënies së ndihmës, strehimit të përkohshëm, dhënies së ndihmës së parë, të shpërndarjes së ndihmave, menaxhon vlerësimin e dëmeve dhe evidentimin e kërkesave për ndihmë, ruajtjen e higjenës dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e kanalizimeve, trajtimin e viktimeve, pritjen dhe trajtimin e grupeve të kërkim-shpëtimit dhe grupeve të vullnetarëve, si dhe probleme të tjera që lidhen me përballimin e emergjencave civile.

Drejtuksi i Operacionit në Qark (DOQ)

-Në situatën e emergjencës civile, burimet materiale dhe njerëzore të listuara në planet e emergjencave të Qarkut, vendosen nën autoritetin e drejtuesit të operacioneve në Qark. Ai është përgjegjës për menaxhimin e operacioneve të emergjencave civile dhe kryen këto detyra:

-Bashkërendon strukturat qendrore në nivel lokal, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombëtare që vijnë në ndihmë.

-Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e tjerë të operacioneve në nivel vendor dhe të qarqeve fqinje, informon dhe kërkon asistencë nga KPPECF në Qark dhe DQO-ja.

Njësitë Vendore:

-Kanë përgjegjësi për përgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gadishmërisë që ato përgatitin dhe rifreskojnë periodikisht,

-Të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore krijojnë dhe mbajnë një sistem të Njoftimit të hershëm dhe informimit të strukturave kryesore.

-Alarmit dhe evakuimit të popullsisë.

Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile.

-Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca civile.

-Komisioni Vendor i Emergjencave Civile (KVEC), përgjigjet për marrjen e masave për parandalimin, lehtësimin, përgjigjen dhe riaftësimin e zonës së dëmtuar.

-Komisioni Vendor i Emergjencave Civile (KVEC) është përgjegjës për:

Hartimin e masave për parandalim, lehtësim, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile.

Sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta.

Vlerësimin e dëmeve dhe të nevojave.

Mbajtjen e kushteve higjienike duke siguruar furnizimin me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe kujdesin për viktimat.

Bashkërendimin dhe mbështetjen për grupet e kërkim-shpëtimit dhe të vullnetarëve.

Çështje të tjera që kanë për qëllim përgjigjen efektive ndaj situatës së emergjencës civile.

Vepronë NË Bashki :

Struktura monitoruese/njoftuese, struktura vepruese/aktive dhe struktura mbështetëse.


Këto struktura në misionin e tyre kanë detyra në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile dhe bashkëpunojnë ngushtësisht me njëra tjetrën në përballimin e emergjencave.

Srukturat monitoruese:


Në Bashki janë, Salla Operative e Policisë së Shtetit, Shërbimi Zjarrfikës, Srukturat e EC në bashki, nëpunësit me funksion të dytë për EC në administratën e njësisë vendore, stacioni hidrometeorologjik, sizmik.

Strukturat vepruese aktive :

Janë forcat operationale, Forcat Vepruese Aktive (Komisariati Vendor i Policisë së Qarkut Dibër, MZSH, Shërbimi Ambulator, Shërbimi Spitalor) të cilët kryejnë funksionet e tyre në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, Këto struktura janë forca të shërbimit të mbrojtjes civile në varësi të Prefektit. Gjithashtu janë pjesë e strukturave të EC vepruese dhe vetë komuniteti



Përgjegjësitë në nivel bashkie/njësi administrative



Strukturat Qëndrore të ndërhyrjes

Kryqi i Kuq, OJF, Grupet Ndërkombëtare, Vullnetarët

Proçesi i planifikimit.

-PPPVEC shërben si burim i gjallë, real si një manual ku përmbledhen informacione, në të cilin janë përshkrur faktorët më të rëndësishëm dhe rolet e të gjitha institucioneve dhe strukturave të përfshira në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile. PVEC nuk do të jetë asnjëherë plotësisht i përfunduar ose i mbyllur, por ai duhet të rishikohet e të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar bashkëpunimin e përhershëm dhe ndryshimet në nevoja dhe burime të Bashkisë Dibër.

Fuqia e PVEC qëndron në bashkëpunimin dhe konsensusin e të gjithë institucioneve dhe strukturave, për të zvogëluar rreziqet, shpëtuar jetë njerëzore dhe minimizuar dëmet që vijnë si rrjedhojë e emergjencave civile në Bashki.

Bashkia e Dibrës është mjaftë e ekspozuar përballë një numri të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore dhe fatkeqësish që mund të vijnë nga veprimtaria njerëzore. Rreziku më i madh nga fatkeqësitë natyrore mund të vijë nga tërmetet, por kohët e fundit rreziqet që vijnë nga zjarret, përmytjet, rrëshqitjet e tokës apo emergjencat dimërore edhe pse të shkallëve të vogla deri tek të mesmet, kanë qenë mjaft evidente. Nisur nga faktorët ekonomik, infrastruktura, mjetet e pakta të komunikimit, emigrimi masiv, si dhe një numër faktorësh që lidhen me shfrytëzimin pa kriter të burimeve natyrore si pyjeve, burimeve ujore, e bëjnë më të prekshme popullsinë dhe ekonominë e saj ndaj këtyre fenomeneve.

Studimi i vlerësimit të rreziqeve përmban seksione të përqëndruara në rreziqe të vecanta për dukuritë e mundëshme të rrezikut si : tërmetet, bllokimi i rrugëve nga bora, rrëshqitjet e tokës, zjarret në pyje dhe sëmundjet e mundëshme infektive. Vlerësimi i rreziqeve është një hap mjaft i rëndësishëm përpara dhe shërben si bazë në procesin e hartimit të PVEC, duke siguruar bazën informative në të cilën mund të hartohet një plan më efektiv. Synimi kryesor i këtij studimi është të japë drejtimet bazë për planifikimin, mbi bazën e të dhënave të të cilit mund të ngrihen skenarë të mundshëm për përballimin e emergjencave civile si dhe të patur informacion për dëmet e mundëshme.

- Qartësia e përgjegjësive, funksionet dhe detyrat themelore, si përgjegjësi dhe si vendimarrje paraprake janë përfshirë në këtë plan.
- Plani inkurajon inisiativa dhe nuk shëndrohet në një instrument ndalues për strukturat dhe njerëzit që duhet të veprojnë.
- Plani do të mbetet një punë në progres, por është një punë mjaft këmbëngulëse për të qëndruar i përshtatshëm dhe për të qenë në gjendje të kapërcejë ndryshimet e mjedisit të jashtëm.

1.4. KUADRI LIGJORË

Proçesi i hartimit të Planit të Bashkisë për Emergjencat civile dhe Fatkeqësive (P.V.E.C.F.) është bazuar në një bazë ligjore, referuar ligjit Nr.45 datë 18.09.2019, “Për Mbrojtjen Civile”.

-Ligji Nr.107 datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut”.

- Vendimi nr.532 datë 01.08.2003, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e departamentit të planifikimit dhe përballimit të Emergjencave Civile.
- Vendimi nr 533 datë 01.08.2003, "Për pjesmarjen e Shtetasve në Parandalimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile".
- Vendimi nr 664 datë 18.12.2002 " Për Kriteret dhe Proçedurat e Shpalljes së Emergjencës Civile "
- Vendimi nr.655 datë 18.12.2002, duke përjashtuar pikat 1,2,6 të cilat janë shfuqizuar, " Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit Kombëtar të Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile".
- Ligji nr.115/2014 datë 31.07.2014, "Për ndarjen administrative- teritoriale të njësive të vetqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
- Vendimi nr.835 datë 03.12.2004, "Për adaptimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile"
- Vendimi i KM nr.148 datë 13.12.2004, "Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar dhe statistikës të Këshillit të Ministrave".
- Vendimi nr.923 datë 25.11.2020, "Për Funksionimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional të Institucioneve dhe të Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile".

Udhëzues / Instrumenta ndërkombëtarë :

UNISDR: Vlerësimi i Aftësisë Ripërtëritëse nga Fatkeqësitë / UNISDR Disaster Resilience Scorecard
 ÈMO- Sistemet me shumë rreziqe të paralajmërimit të hershëm.
 MHEËS-Multi-Hazard Early Warning Systems.

Udhëzues dhe direktiva të BE :

Udhëzimet e Vlerësimit dhe Hartimit të Riskut për Menaxhimin e Fatkeqësive Sec (2010) 1626 final
 Direktiva e Përmbajtjes 2007/60 e Komisionit Evropian / EU Floods directive 2007/60 EC.

Direktiva e Ujit 2000/60 e Komisionit Evropian EU UFD2000/60 EC.

Udhëzues për Vlerësimin dhe Hartëzimin e Riskut për Menaxhimin e Fatkeqësive të Komisionit Evropian Sec (2010) 1626 final – EU Risk Management Capability Assessment Guidelines (2015/C 261/03

Institucionet dhe strukturat e ndryshme në aktivitetin e tyre të përditshëm funksionojnë mbi bazën e akteve ligjore, shumë prej të cilave në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi prekin probleme që kanë të bëjnë me emergjencat civile. Për këtë arsye PVEC i është referuar dhe ka marrë shumë nga ato, për të qenë i bazuar dhe i zbatueshëm .

-Kjo është bërë për t'i dhënë hapësirë ligjore zbatimit të këtij plani, duke i dhënë mundësinë strukturave shtetërore dhe jo shtetërore për të vepruar në mënyrë efektive dhe t'i përmbahen detyrimeve ligjore në lidhje me emergjencat civile.

-Formati i P.V.E.C.F., reflekton kërkesat e bazës ligjore për shërbimin e Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive (SH.E.C.F) në Shqipëri dhe në këtë mënyrë përmbledhur katër seksione të veçanta të cilat prezantojnë katër fazat kryesore të ciklit të Emergjencave.

2. KONTEKSTI GJEOGRAFIK :

Bashkia Dibër është vend që ndodhet në Shqipërinë Veri-Lindore dhe shquhet për pjerrësinë e madhe të shpateve malore dhe kodrinore (>30%), për bimësinë dhe pyjet e shumta në territor si dhe për reshjet e dendura të dëborës.

-Bashkia Dibrës ka 15 Njësi Administrative dhe 141 fshatra.

Qendra e **Bashkisë** të Dibrës ndodhet në qytetin e Peshkopisë

Bashkia Dibër kufizohet në lindje me Maqedoninë. E gjithë zona është malore dhe përfshin rajonin historik të Dibrës së Vogël në veri me Qarkun e Kukësit, në jug me Bulqizën, në jug – perëndim me bashkinë Klos, në perëndim me bashkinë e Matit në veri – perëndim me Bashkinë Mirditë.

Bashkia e Dibrës bën pjesë në rajonin veri-lindor me një reliev përgjithësisht kodrinor-malor me një sipërfaqe prej **937.88** km². Pra shtrihet në Veri-lindje të Shqipërisë në dy anët e luginës së Drinit të Zi duke u kufizuar në lindje nga vargmali i Korabit dhe në perëndim nga vargmalet e Lurës.

Qendra e Bashkisë është qyteti i Peshkopisë. Qendra e Bashkisë (Peshkopia) shtrihet 185 km nga kryeqyteti dhe 21 km largësi nga pika e doganës së Bllatës në Maqellarë.

-Bashkia Dibër ka në ndarjen Administrative-Territoriale, 15 Njësi Administrative.

	Bashkia	njesi administrative	fshatra	popullsia
1	Dibër	15	141	75349

3.SKENARËT E RREZIKUT

Metodologjia.

Identifikimi i Riskut

Rreziqe prezente në territorin e Bashkisë

Rreziqet nga dëborë.

Rreziqet nga zjarret.

Rreziqet nga rrëshqitjet e tokës.

Përmbytjet.

Rreziqet sizmike .

Rreziqet nga aktet terroriste.

Rrëziqet nga dëborë:

Është rreziku periodik vjetor që përfshin Bashkinë e Dibrës.

Bashkia e Dibrës është e vendosur kryesisht në zonën e klimës mesdhetare paramalore dhe malore, nënzona veriore dhe lindore.

Në stinën e dimrit, pjesa më e madhe e reshjeve bie në formë dëborë, që fillon nga muaji Nëntor deri në fund të muajit Mars.

Trashësia mesatare e dëborës arrin nga 20 cm deri në 120 cm, kurse në zonat malore 1000 m mbi nivelin e detit arrin 150 cm deri në 300 cm.

Për një periudhë 30 vjeçare veçori janë vitet 1985 me temperaturë absolute -22 gradë C me datë 19 shkurt lartësia e borës arriti nga 115 cm deri në 400 cm.

Numëri mesatar i ditëve me dëborë është 24 ditë. Më shumë zgjat në muajtë Dhjetor- Janar 12.4 ditë.

Numri mesatar i ditëve me dëborë shkon nga 40 deri në 100 ditë.

Erërat veriore e verilindore janë karakteristike të periudhës dimërore të cilat përbëjnë 23.6% të të gjitha rasteve. Shpejtësia e erës mesatare shkon 11-15 m/s.

Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5-10 mm, që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal dhe prek, madje pengon operacionet e emergjencës.

Megjithatë, grumbullimi i dëborës rreth 25-30 cm e bllokton tërësisht qarkullimin e makinave të zakonshme. Në rast se nuk bëhet pastrimi rregullisht prej dëborës, trafiku mund të bëhet vetëm me

automjete të posaçme.

Bllokimi i popullsisë - rrëziku dhe elementët e parapërgatitjes.

Mundësia e bllokimit të popullsisë nga dëbora, e llogaritur si popullsi banuese brenda konturit të hapësirës që mbulohet me dëborë me lartësi të paktën 30 cm shkon deri në 51.3 % në kushtet e klimës më të shkajshme e në ato të zakonshme varion 20-25 %. Duke mbajtur parasysh rezervat e ushqimit brenda shtëpive dhe furnizimeve të tjera, si dhe stoqet e tregut në vend, një periudhë bllokimi më e gjatë se 30 ditë duhet të quhet kritike për planifikimin e parapërgatitjes për emergjencat.

Në Shkurt 2012, Bashkia e Dibrës, si pasojë e situatave emergjente dimërore ishte nga teritoret më tërënduar nga emergjencat civile.

Infrastruktura aktuale e Rrugëve Nacionale ka krijuar fenomenin e frymarrjes në qarkullimin e njerëzve, mjeteve e mallrave duke influencuar drejtëpërsëdrejti në përballimin e emergjencave civile. Kompanitë kontraktore kanë krijuar një bazë llogjistike të kënaqshme për ndërhyrje. Gjatë këtij viti janë vënë në funksion 19 borëpastruese pa përmendur mjetet e tjera ku në krahasim me vitin 2007,2012, ishin vetëm 4 borëpastruese.

Rreziku prej ortekëve :

Bashkia e Dibrës është me male me pjerrësinë e madhe të shpateve malore dhe kodrinore (> 30%), me bimësinë vende vende të shumtë dhe me pyjet të shumtë në disa zona, si dhe shoqëruar me reshjet e dendura të dëborës të ortekëve të cilët për shkak të shpërndarjes demografike të popullsisë shpesh shoqërohen me dëme.

Dëbora e madhe dhe ortekët e shpeshtë kanë shkaktuar dëme të ndjeshme në periudhat dimërore e kryesisht në periudhën janar –shkurt 1985, si pasojë e dëborës së madhe u shkëputën shumë ortekë dhe u dëmtuan disa banesa.

Zonat me rrezikshmëri të lartë janë :

Bashkia Dibrë: Shpati perëndimor i malit të Korabit, Shpati perëndimor përgjatërrugës Peshkopi-Kukës.

Rrëziqet nga Zjarret:

Sezoni veror në Bashkinë e Dibrës, shoqërohet me temperatura të larta, pasojë e së cilës është fenomeni i zjarreve. Sipas statistikave mesatarisht për çdo vit kemi dëme si pasojë e zjarreve në banesa mbi 25 e në biznese private mbi 5-10 raste me dëme të konsiderueshme ekonomike.

Problematikë për Bashkinë tonë janë zjarret në pyje.

Bashkia e Dibrës ka sipërfaqe të konsiderueshme pyjore :

Rreth 73 % e popullsisë së Bashkisë të Dibrës jeton në zona rurale dhe varet kryesisht prej veprimtarive të bujqësisë ekstensive dhe blegtorisë. Keqpërdorimi i pyjeve nga njerëzit dhe praktikat e kullotjes, padyshim, janë shkaktarët e pjesës më të madhe të shkatërrimit të pyjeve.

Kullotja e pakufizuar dhe zjarret e pakontrolluara, të shkaktuara aksidentalisht dhe shpesh për shkak të djegies me qëllim, pastrime kullotash, vijnë të ndodhin në shkallë Bashkie.

Dëmet e korjeve, të shkurreve e të kullotave dhe humbjet përkatëse, që për një vit arrijnë në miliona lekë, që janë humbje të drejtpërdrejta ekonomike.

Gjatë periudhës së stinës së verës sidomos me ato të thata zjarret kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në masivet pyjore e kjo sidomos në vitet 2007,2008, 2012, 2016, 2017, 2018, 2020. Në këto vite janë dëmtuar qindra ha pyje nga ato të reja deri në dhjetra vjeçare.

Denduria e zjarreve të pyjeve ndryshon gjeografikisht, duke qenë më e lartë në rrethin e Dibrës.

Shkaqet kryesore të zjarreve janë pakujdesia e njerëzve, djegia për kullota natyrore dhe shumica e dëmeve ndodhin në pyjet halore e pyje të larta.

Masat për menaxhimin e zjarreve, që janë përdorur nga strukturat përgjegjëse kanë qenë:

Vënia në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi, vigjilencë për rastet gjatë gjithë periudhës së shtimit të rrezikut të zjarreve dhe ndërtimi i pritave kundër zjarrit.

Duke u ballafaquar me këtë problem kaq të mprehtë, tashmë ekziston një strategji e mbrojtjes së pyjeve e cila kërkon kontributin e të gjithë strukturave për tu bërë efektive dhe për të arritur rezultatet e pritshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare siç janë pyjet.

Deri tani reagimi e përgjegjësia nga njësitë vendore kanë qenë të pakta për Bashkinë Dibër, ose në nivele të papërfillshme.

Është koha të mendohet për një sistem unik të përgjigjes ndaj zjarreve si sistemi i vrojtimit e lajmërimit apo evakuimit të popullatës në rrezik.

Modernizimi i strukturës operacionale si me zjarrfikëse deri në helikopter.

Rrëshqitja e tokës:

Vlerësimet e rrezeve të mundshme nga rrëshqitjet e tokës.

Bashkia e Dibrës ka si tipar të prekshëm, paqëndrueshmëritë masive të tokës, këto lloj fenomenesh gjeodinamike janë pasojë e kombinimit të faktorëve pasiv ku futet, ndërtimi gjeologjik dhe relievi, pjerrësia e madhe e shpateve si dhe e një rrjeti hidrografik të shumtë në të cilën lëvizin ujrat me shpejtësi të madhe. Më të rrezikshme paraqiten në situatën kur këta shkëmbinj bien në drejtim të shpatit.

Një rol tejet negative ka luajtur vetë njeriu nëpërmjet shpyllëzimit e formimit të tokave të reja arë, ku sipas llojit të paqëndrueshmërisë së tokës kemi këto veçori në Bashkinë e Dibrës:

Rënia e shkëmbinjve që është karakteristikë e rajoneve malore të Alpeve të Shqipërisë, e shpateve gëlqerore të zbuluara ndaj kushteve të klimës së ftohtë dhe shirave të bollshme në masivin e shpatit të malit të Korabit. Këto veçori janë në Sllovë. Gjatë kësaj periudhe ky fenomen ka përfshirë edhe segmente të rrugës nacionale Maqellarë-Peshkopi.

Shembjet : janë karakteristikë për rajonet malore të Bashkisë.

Rrëshqitjet kryesore janë në zonën tektonike-forciale të Korabit, ndërsa fshatrat më të rrezikuara janë, Sllova, Dypjaka, Krej - Reçi.

Janë mbi 15 objekte banimi të cilat me kalimin e viteve do të kenë probleme të drejtëpërdrejta me këtë fenomen.

Rreshjet janë fenomene të kufizuara.

Erozioni vjen si rezultat i shpyllëzimeve dhe pjerrësive të larta të terrenit, mosfunksionimi i ujrave sipërfaqësore, si dhe mos sistemimi i ujrave sipërfaqësor.

Në këtë kuadër nga Bashkia është kërkuar nga institucionet e specializuara, që të bëhet një studim i plotë në shkallë Bashkie për gjendjen e këtij fenomeni si dhe propozimin e masave me afate kohore të menjëherëshme deri në ato afatgjata.

Duhet të bëhet një rishikim i plotë në nivel lokal, rajonal në lidhje me situatën e reshjeve, planet dhe veprimet e strukturave si dhe cilësia e operacioneve të ndërmarra në fazën e përballimit.

Rrëziqet nga tërmetet:

Bashkia e Dibrës ashtu si vetë pozicioni i vendit tonë që shtrihet në brezin sizmik, alpin-mesdhetar, që përfshin zonën e kontaktit ndërmjet pllakave litosferike të Afrikës e të Euroazisë, e cila shtrihet nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të pellgut të Mesdheut.

Bashkia e Dibrës është shtrirë në zonat e ashtuquajtura "mesatare" për sa i përket intensitetit të terrmeteve. Shkalla e intensitetit është 6 deri në 7 ballë. Origjina e terrmeteve në Bashkinë tonë është e karakterit tektonik. Faktorët që ndikojnë në intensitetin e terrmeteve është edhe fortësia e shkëmbinjve. Kemi tre lloje shkëmbinjsh me forcë të lartë mesatare e të ulët.

Bashkia e Dibrës ka shkëmbinj me forcë relativisht të lartë dhe të ulët që përfaqësohen nga mbulesat e aluvioneve dhe deluvioneve dhe intensiteti i terrmeteve me veprat inxhinierike që janë ndërtuar në shkëmbinj të fortë, është më i vogël se në veprat inxhinierike që janë ndërtuar mbi veprat e aluvioneve dhe deluvioneve. Bashkia e Dibrës është goditur nga terrmetet në vite 1967, 1979, 1998 e në fund të vitit 2008, 2018, 2019, ku kryesisht ka patur dëme në objekte ndërtimi.

Vlerësimi i rrezikut nga terrmetet është realizuar për periudha përsëritje 50, 100, 200, 475 dhe 1000 vjet.

Përdorimi i hartës aktuale të zonimit sizmik është përcaktuar për projektimin e ndërtesave të zakonshme, aktualisht për vepra të rëndësishme dhe objekte të larta për të cilat është detyrim ligjor të bëhen studime të detajuara inxhiniero-sizmiologjike për të nxjerrë të dhëna konkrete në lidhje me rrezikun sizmik për sheshe konkrete ndërtimi.

Nëpërmjet studimit, "Vlerësimi i Rreziqeve në Shqipëri", për herë të parë është bërë vlerësimi tërësor i elementeve të domosdoshme për nevoja planifikimi dhe menaxhimi të emergjencave shkaktuar nga terrmetet.

Rreziku i përmbytjeve.

Përmbytjet e shkaktuara nga lumi i Drinit të Zi, dhe përrenjtë malor, shpesh prekin luginat e Bashkisë të Dibrës, duke dëmtuar rrjetin rrugor dhe përmbytje të tokave bujqësore, të cilat janë, lumi Drini të Zi, ose përrenjtë që përfaqësojnë një rrezik të përhershëm për përmbytje. Karakteristika kryesore e tyre është se janë shumë të shpejtë dhe shpesh të "pa besë", si dhe sjellin volume të mëdha aluvionesh dhe mund të shkaktojnë dëme të pa parashikueshme si në infrastrukturën rrugore, në objekte banimi, banesa sociale, gjënë e gjallë dhe bujqësi.

Digat dhe rreziqet

Ngritja e digave dhe argjinaturave në Bashkinë e Dibrës, ka nisur që viteve '60-70'. Digat e para u ndërtuan për qëllime bujqësore. Sot ka 22 sisteme rezervuare dhe 5 liqene me diga, lartësia e të gjitha digave varion nga 10 m deri në 37 m. Të gjitha digat e larta në Bashkinë tonë janë të tipit me mbushje dhe e gurë e beton. Gjithashtu për gjatë Drinit të Zi, janë të ndërtuara mbi 2930 ml, argjinatura mbrojtëse për shkak të përmbytjeve që sjell Drini i Zi, në periudha me rreshje shiu e dëbore.

Kushtet ekzistuese.

Projektimi dhe ndërtimi i digave mbështetet në një analizë të gjithanshme të të gjithë faktorëve që lidhen me të dhe që prekin sigurinë e vetë digës si dhe të sistemit digë/rezervuar. Për të siguruar kufijtë e sigurisë së projektuar gjatë gjithë periudhës së ekzistencës, rëndësi të dorës së parë ka mirëmbajtja e sistemeve gjatë shfrytëzimit të tyre. Mirëmbajtja e rregullt dhe e frytshme, duke përfshirë rehabilitimin në kohën e duhur, të cilat janë në veçanti thelbësore për sistemet digë/rezervuar të ndërtuara me dhe e gurë. Me vjetrimin e digave, siguria e punës së tyre është problem. Kjo kërkon më shumë vëmendje në formën e inspektimeve, vlerësimeve, modifikimeve dhe

përmirësimin të digave të vjetëruara, në mënyrë që të përballojnë standartet dhe rregullat e teknologjisë së kohës. Digat në Bashkinë e Dibrës prekin një popullsi prej 15000-20000 banorë.

Rrëzimet nga aktet terroriste:

Duhet theksuar se Bashkia e Dibrës nuk ka përjetuar ndonjë sulm terrorist dhe në përgjithësi nuk konsiderohet si një vend me rrezik të veçantë për sulmet terroriste. Sidoqoftë ngjarjet e sulmeve terroriste janë rritur, prandaj ky rrezik është prezent.

Hartat e Rrezikut e Riskut.

Skenarët e Riskut

BLLOKIMET NGA DËBORA

A.Akset rrugore që përshkojnë Bashkinë Dibër:

Akset rrugore nacionale:

Bashkia Dibër përshkohet nga 71 km rrugë nacionale.

SEGMENTET RRUGORË QË DO TË PARAQESIN VËSHITRËSI MË TË MËDHA MUND TË JENË ATO SI:

- Peshkopi-Kala e Dodës, e cila sjell izolimin e të gjithë fshatrave të këtyre njësive administrative.

Rreshjet e dëborës ;

Për vetë terrenin malor që karakterizon Bashkinë Dibër, rreshjet e dendura të dëborës dhe temperaturat e ulta janë evidente në stinën e dimrit, p.sh. viti 1985, 2011, 2015, 2016, 2017, 2020, ku janë shoqëruar me bllokime rrugësh nacionale Peshkopi-Kala e Dodës, Peshkopi-Lurë etj, dhe rrugët rurale me qendrat administrative të njësive administrative Selishtë, Kala e Dodës, Lurë, Zall Dardhë e Reç të Bashkisë Dibër, për të cilat disa herë është ndërhyrë edhe me mbeshtetje me mjete e ndihma nga institucionet qendrore, për ato në nivel vendor.

-AKSET RRUGORE NACIONALE NË BASHKINË E DIBRËS JANË :

-Segmentet më të rrezikuara të akseve nacionale prej 71 km, të cilat sjellin dhe bllokimin për qarkullimin e automjeteve, janë si më poshtë:

-Segmenti rrugor Peshkopi – Kala e Dodës 35 km

-Segmenti rrugor Peshkopi-Muhurr 11 km

Strukturat menaxhuese të rrugëve nacionale të Qarkut tonë janë pjesë përbërëse në Drejtorinë e Rajonit Verior të rrugëve nacionale me qendër në Shkodër.

Aktualisht Bashkia Dibër për monitorimin dhe ndjekjen e problemeve të akseve rrugore nacionale, sistrukturë drejtuese ka Sektorin Dibër me përberje: 1 përgjegjës e 2 specialistë.

Nga rikonstruktimi i këtyre strukturave të gjitha akset rrugore nacionale mirëmbahen nga sipërmarrës privat.

Nga ana e Firmave kontraktore janë marrë masat e nevojshme, për përgatitjen e periudhës dimërore.

Sipas informacioneve të marra nga drejtuesit e firmave kontraktore, këto akse rrugore janë të dhëna të gjitha me performancë e konkretisht:

Sipas kontrolleve të kryera gjëndja e teknikës është në gadishmëri dhe posedohet baza materiale e domosdoshme për realizimin e detyrave në drejtim të përballimit të emergjencave dimërore.

Nga ana e Firmave kontraktore janë marrë masat e nevojshme, për përgatitjen e periudhës dimërore. Kontraktorët kanë marrë masa për riparimin e mjeteve të rënda që disponojnë në performancën e tyre, në gadishmëri për periudhën dimërore.

b.SISTEMI RRUGOR NË ADMINISTRIM TË BASHKISË (Rrugët Rurale).

Bashkia e Dibrës ka rrugë në administrim gjithsej 688 km.

BLLOKIM TË AKSEVE RRUGORE RURALE MUNDË TË KEMI NË:

Rrethi Dibër, ka një shtrirje në rrugët rurale gjithsej 688.7km.

Peshkopi - Maqellarë	38.5 km	Peshkopi - Melan	27.1 km
Peshkopi - Tomin	47.4 km	Peshkopi - Fushe Çidhën	30.1 km
Peshkopi - Sllövë	35.0 km	Peshkopi - Kala e Dodës	19.5 km
Peshkopi - Luzni	32.4 km	Peshkopi - Arras	95.0 km
Peshkopi - Muhurr	68.0 km	Peshkopi - Zall Dardhë	42.2 km
Peshkopi - Selishtë	26.6 km	Peshkopi - Zall Reç	38.5 km
Peshkopi - Kastriot	37.7 km	Peshkopi - Lurë	71.0 km
Peshkopi rrugë të brendëshme	21.7 km		
Muhurr - Selishtë - Ura Varoshit	33km	Arras - Lurë	25 km

Sipas informacioneve të marra Bashkia Dibër ka marrë masat përkatëse, për përballimin e emergjencave dimërore, kryesisht në mbajtjen e akseve rrugore në inventar por ka mangësi në mjete për pastrimin e dëborës, për të cilën është kontraktuar me operatorët privat, për mbajtjen funksionale të rrugëve rurale në teritorin e tyre.

Ka gjendje një fond për emergjencat civile rreth 8 milionë lekë.

Temperaturat e ulta rrezikojnë ngrirjen e tubacioneve të ujit të pijshëm në të gjithë qytetin, njësitë administrative.

Bllokimi i tubacioneve mund të jetë i pjesshëm, në segmente të veçanta të cilat janë në afërsi të sipërfaqes së tokës. Fenomeni i cili është evident për linjat dytësore.

Po punohet nga bashkitë në Zbatim të Planit të Veprimit, për marrjen e masave në përballimin e Emergjencave Civile, si në shfrytëzimin e rezervave ashtu dhe në kontraktimin e lidhjeve të marrëveshjeve me të tretët, për kontratat e domosdoshme që kërkohen në përballimin e emergjencave dimërore.

Punë paraprake:

Mbjajtjen në gadishmëri të mjeteve.

Sigurimi i bazës materiale.

Mbushja e gropave.

Pastrimi i kanaleve anësore e turbinave.

Hartimi i Projekt-Preventivave parashikues.

Grafiku i shpërndarjes së mjeteve me të tretët.

Problematike janë akset rrugore rurale si:

Peshkopi-Lurë.

Rruga nacionale Topojan -Peshkopi

Rrugë nacionale Kuben-Kala e Dodës

Peshkopi-Zall-Reç.
Peshkopi-Selishtë
Peshkopi - Luzni

KAPACITETET:

Mjetët që vihen në dispozicion:

Detashmenti i Mbështetjes Rajonale të ushtrisë.

Detashmenti i Mbështetjes Burrel, ka në gadishmëri këto forca dhe mjete

- Mjet transporti tip.IVEKO	3 copë
- Autozjarrfikës	2 copë
- Autoambulancë	1 copë
-Varka	10 copë
-Motor varke	1 copë
-Karroguzhinet	1 copë
-Forca njerëzore personel i gatshëm	25-30 efektive

***STRUKTURAT E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI
(M.Z.SH.) BASHKIA DIBER***

Bashkia Dibër 1 mjet shpëtimi ka 2 mjete zjarrfikës 21 personel

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura

Një grup i gatshëm i përbërë prej 15 vetash.

Automjete tip "TATA" 2 copë.

Komisariati Vendor i Policisë së Shtetit.

Një grup i gatshëm i përbërë prej 76 punonjësish.

Drejtoria e OSHEE-së Njësia Dibër

2 foristrada.

1 autovinç.

1 kamionçinë.

1 grup punonjësish prej 40 personash për mbajtjen në gadishmëri të të gjitha linjave elektrike.

Drejtoria e Shëndetit Publik.

43 personel

2 laborator

20 ambiente të lira

1 Mjet transporti (ambulancë)

Shërbimi Spitalor.

227 personel

8 autombulanca në gadishmëri 24 orë

253 shtrëtar për rastet e emergjencave civile.

1 laborator

Bashkia :

60 punonjës. 5 mjete transporti, 1 mjete vetshkarkues, 1 eskavator, 1 fadroma, 1 vinç, 1 autobot

Subjektet private për rrugët :

Drejtoria Rajonale e Rrugëve nacionale Dibër disponon:

N/R	Sektori Rrugor Rural dhe Firmat kontraktuese	Borë pastrues e	J.K.B. Fadroma	Grejder	Kamion ë	Kamionçin ë mjet	punonjes
1	KOTARJA sh.p.k	3	5		5	1	20

Llogaritja e konsumit ushqimorë për periudhën një mujore rë parashikuar:

Nr	Rrethet	Nr-i Popullsisë banorë	Norma mujore e konsumit për fryme ne kg	Konsumi për një muaj ton
1	Dibër	75349	15	1130

Shërbimi Shëndetësor:

Në shkallë Bashkie është kjo strukturë shëndetësore e cila do të shërbejë për rastet e emergjencës.

Dibra

Spitali Civil	1
Spital Infektiv	1
Spital Obsetrik Gjinekologjik	1
Kapaciteti me shtretër	358
Qendra Shëndetësore	15
Ambulanca	9

Personeli mjekësor është i specializuar (ka pak në numër) për spitalin Dibër për të bërë ndërhyrje kirurgjikale.

Furnizimi me ujë të pijshëm

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm kryhet nga:

Sh.a Ujësjiellësi Dibër për Bashkinë e Dibrës.

Ujësjiellësi i Bashkisë të Dibrës, e bëjnë furnizimin me ujë të popullatës me rrjedhje të lirë. Nga Sh.a Ujësjiellësa-Kanalizime, punohet për masat e nevojshme për periudhën dimërore e verore, me qëllim sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës.

Janë marrë masat për furnizimin me mjete ngrohëse dhe me materiale dizinfektuese të ujit të pijshëm për periudhën dimërore.

Problematike mbetet rrjeti i amortizuar i Ujësjiellësave e gjendja e mjeteve dhe pamundësia financiare për të ndërhyrë.

Furnizimi me energji elektrike.

Furnizimi me energji elektrike në Bashkinë e Dibrës bëhet nga OSHEE:Njësia Dibër

Për problemet e arsimit

Në kushtet e Emergjencës Civile Dimërore mund të bëhet bllokimi i aktivitetit të mësimdhënies në shkolla si më poshtë:

Bashkia Dibër

NjAdm. Selishtë, Lurë, Kala e Dodës, Sllovë, Reç e Zall Dardhë

Për përballimin e situatës dimërore nga drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me organet vendore, për periudhën dimërore janë marrë masat, për furnizimin me lëndë ngrohëse të objekteve shkollore.

-Në rast bllokimi total të këtyre rajoneve në zbatim të akteve normative, me propozim të drejtorit të shkollës apo organit vendor nga Zyrat Vendore Arsimore, nxirret urdhëri për pezullimin e mesimdhënies për një periudhë 2 javore për ciklin 9-vjeçar e 2 javore për shkollat e mesme

Me nxjerrjen e këtij urdhëri njoftohet menjëherë Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve.

Kjo periudhë mësimdhënie do të zëvendësohet në periudhën e verës.

Në rast se kjo periudhë e emergjencës dimërore do të zgjasë mbi këto kufij, atëherë do të organizohet mësimdhënie me grupe mikse të nxënësve me mësues sipas fshatrave.

I. SKENAR PËR QËLLIME PLANIFIKIMI.

-Në muajin dhjetor dhe në vazhdim kushtet klimaterike nga reshjet e shiu të dobëta u kthyen në reshje të shumta dëbore ku u përfshi i gjithë rajoni i Bashkisë Dibër. Lartësia e reshjeve të dëborës variojnë nga 20-120 cm.

-Në akset Rrugore nacionale, kemi rënie inertesh gurësh e rrëshqitje të skarpatave, të cilat kanë bërë bllokimin e përkohshëm të disa akseve.

-Automjete udhëtarësh kanë dalë nga rruga për pasojë janë dëmtuar disa shtetas nga të cilët edhe në gjëndje të rëndë.

Aktualisht ka rezerva ushqimore, por sipas informacionit që kemi 30 % e fshatrave të Njësive Administrative pas një periudhe 7 ditore do të kenë probleme ushqimore.

Erërat me drejtim nga Veriu kanë filluar të shkaktojnë problemet e para në drejtim të dëmtimit të linjave të furnizimit me energji të Bashkisë, ku kemi dëmtime të rrjetit transmetues të energjisë e për pasojë ka patur morfurnizim me energji të njësive Lurë, Selishte, Kala e Dodës, Zall Dardhë, Reç

Janë dhënë sinjalet e para të ngrirjes së tubacioneve të furnizimit me ujë të pijshëm në qytetin e Peshkopisë.

Bllokimi i tubacioneve mund të jetë i pjesshëm në segmente të veçanta të cilat janë në afërsi të sipërfaqes së tokës.

Ky fenomen është evident për linjat dytësore.

Temperaturat e sidomos ngricat bëjnë të domosdoshëm sigurimin në vazhdimësi të rrymës elektrike .

Dëmtimi i linjave të furnizimit me energjinë elektrike në:

Kala e Dodës-Peshkopi, Kala e Dodës-Sillovë, Lurë e Selishtë,

POPULLSIA NË RREZIK:

Bllokimi total i popullsisë së Bashkive:

Bashkia Dibër

Nj. Adm. Selishtë : Fshatrat Kacni, Selishë, Lukan, Qafë Murrë

Nj. Adm. Luzni: Fshatrat : Katundi i Ri, Hotes, Lishan i Poshtëm, Lishan i Sipërm, Arap i Sipërm, Arap i Poshtëm

Nj. Adm. Melan: Fshatrat : Cerjan, Rabdisht, Zagrad, Illice, Bellovë,

Nj. Adm. Tomi : Fshatrat: Bahute, Shimçan, Zimur.

Nj. Adm. Lurë : Fshatrat: Lurë, Borie Lurë, Arth, Gurë Lurë, Lurë e Vjetër, Arrmollë, Krej Lurë, Pregjë Lurë, Sumej, Vlashaj.

Nj. Adm. Reç : Fshatrat: Zall Reç, Bardhaj Reç, Draj Reç, Gur Reç, Hurdhë Reç, Kraj Reç, Ndërshenë, Qafdraj, Tharkë.

Nj. Adm. Arras: Fshatrat : Guri i Zi, Lazrej, Kodër Leshaj, Mustafe, Sinë e Sipërme, Sinë e Poshtme, Çidhën, Grykë Nokë.

Nj. Adm. Zall Dardhë: Fshatrat: Zall Dardhë, Lashkizë, Lugjej, Menesh, Nezhaj, Qa, Soricë, Shënllëshën, Tartaj.

Nj. Adm. Kala e Dodës ; Fshatrat : Ceren, Kullas, Ploshtan, Radomirë, Shullan, Tejzë, Ujëmirë, Vasie.

IV. ORGANIZIMI PËRGJEGJËSITË E BASHKËPUNIMI:

a. Shërbimet që do të përfshihen në kushtet e emergjencës do të jenë:

Spektori i Rrugëve Nacionale

Drejtoritë e Rrugëve Rurale në bashkitë Dibër,

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik

Komisariat i Vendore i Policisë së

Shtetit

Drejtoria Vendore e Policisë Kufirit dhe Migracionit

MZSH-të

Ujësjellësit Dibër

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës

Kryqi i Kuq dega Dibër me degët :

Autoriteti Rrugor Verior Shkodër

Biznesi Pri vat

Komuniteti
Media
Shërbimi Sinoptik

Puna që do të bëjnë :

Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër do të bëjë planizimin për organizimin e punës për mbajtjen në gadishmëri të akseve nacionale.

Prioritet kryesor do të ketë aksin Topojan-Peshkopi dhe Peshkopi-Kala e Dodës.

Me strukturat e saj nëpërmjet Firmave Kontraktore do të ndërhyhet në rastet e fatkeqësive (bllokim e shembje të rrugëve) për të rivendosur gjendjen.

Do të monitorojë gjatë gjithë kohës aktivitetin e firmave kontraktore të cilat kanë akset rrugore nacionale.

Me mjetet që kanë në dispozicion do t'i japë ndihmë strukturave të akseve rrugore në bashki në momentet që do të kërkohet nga Komisioni i Emergjencës Qarkut.

Bashkitë do të planizojnë në aktivitetin e saj, për mbajtjen në gadishmëri të rrugëve rurale duke realizuar lidhjen e Njësive Administrative me qendrat e bashkive.

Bashkia të bëjë vlerësimet e përlogaritjet në mënyrë të vazhdueshme të gjendjes së ushqimeve të domosdoshme, vijueshmërinë e furnizimit me ushqimet bazë të popullatës. Gjëndjen e blegtorisë dhe masat e marra për rezervat e bazës ushqimore për sezonin dimëror.

Bashkia do të mbajë nën vëzhgim objektet me rrezikshmëri duke marrë masat përkatëse përsinjalizim dhe evakuim të popullatës në bashkëpunim me organet vendore.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit gjatë gjithë kohës do të ushtrojë kontroll mbi cilësinë e ushqimeve si ato që tregëtohen si dhe ato që konsumohen. Në vëmendje të veçantë do të ketë mallrat që vijnë nga jashtë e kontrollin e cilësisë së ndihmave ushqimore.

Drejtorita e Shëndetit Publik e Spitalor do të jenë në gadishmëri për përballimin e emergjencave shëndetësore si në shërbimet spitalore deri tek qendrat shëndetësore.

Krijimin e rezervave me medikamente shëndetësore si në shërbimet spitalore deri tek qendrat shëndetësore.

Nga spitalet të mbahet në gadishmëri 30 shtretër për përballimin e fatkeqësive të cilat mund të shkaktojnë dëme në njerëz.

Të mbahet në gadishmëri të plotë reparti i urgjencës me llogjistikën e nevojshme.

Komisariati Vendore i Policisë së Shtetit, do të mbajë nën kontroll rendin e qetësinë publike në shkallë territori dhe do të japë kontributin e saj në mjete dhe njerëz në raste fatkeqësish.

Të marrë nën kontroll territorin në të cilin ndodh fatkeqësia duke marrë pjesë drejtëpërdrejtë në operacionet e ndërhyrjes.

Do të mbajë nën kontroll të vazhdueshëm akset rrugore duke ushtruar kontrolle të vazhdueshme për levizjen e mjeteve të komunikacionit.

DMR (Detashmenti i Monitorimit Rajonal të F.A): Do të marrë pjesë në operacionet e shpëtimit dhe ato humanitare me mjetet dhe forca në situatën e emergjencës.

Bordi i Kullimit do të mbajë nën vëzhgim objektet me rrezikshmëri duke marrë masat përkatëse për

sinjalizim dhe evakuim të popullatës në bashkëpunim me organet vendore.

OSHEE në shkallë Bashkie do të mbajë në gadishmëri rrejtin me furnizim të energjisë të popullatës në marrjen e masave në eliminimin e avarive që mund të ndodhin.

Sh.a Ujësjetles: do të mbajnë në gadishmëri linjat me furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës të prekur nga fatkeqësia duke ndërhyrë me grupet e gadishmërisë, për eliminimin e emergjencave në këtë shërbim publik.

MZSH-së do të marrin pjesë në veprimtaritë e kërkim shpëtimit në ato rajone ku ka fatkeqësi.

Kryqi i Kuq Rajonal si partner kryesor, do të bashkërendojë punën me komisionin e emergjencës në shkallë Bashkie për të vepruar në veprimtaritë humanitare.

Rezervat Materiale të Shtetit, bëjnë programimin e punës për krijimin e shpërndarjen e rezervave materiale në zonat e prekura nga fatkeqësitë.

Tatim-Taksat do të ndjekin me përgjegjësi e kontroll të rreptë të abuzuesve të çmimeve kryesisht atyre ushqimore.

Drejtoria Rajonale Doganore punon për lehtësimin e procedurave doganore për rastet e dhënies së ndihmës nga jashtë.

Biznesi privat do të punojë për krijimin e rezervave logjistike në përballimin e fatkeqësive.

Shërbimi sinoptik do të japë dy herë në ditë informacion për situatën sinoptike.

Me median do të koordinohet puna për pasqyrimin e aktiviteteve të shërbimeve e sensibilizimin e opinionit publik në përballimin e fatkeqësive.

C. PËR BASHKËPUNIMIN ME BASHKITË FQINJË.

Organizimi i bashkëveprimit ndërmjet Bashkive realizohet kryesisht me bashkinë e Kukësit, bashkinë e Bulqizës, bashkinë e Burrelit, Bashkinë e Mirditës dhe një pjesë të njësisve me Maqedoninë që janë fqinjë përgjatë kufirit shtetëror, për veprimet të përbashkëta e ndihmë të ndërsjellta.

Për transportimin e të sëmurëve në Qendrën Spitalore Peshkopi.

Po i njëjti bashkëveprim do të realizohet me komunën e Dibrës së Madhe Maqedoni për Njësitë Administrative të Dibrës.

Bashkëveprimi do të jetë me të gjithë fqinjët për dhënie e marrje informacioni.

a. Anetarët e Komisionit të Emergjencave Civile të Bashkisë Dibër.

- Rahim Spahiu	Kryetari Bashkisë	Kryetar
- Ruzhdi Deda	Nënkryetar Bashkie	Zv. Kryetar
- Sajmir Kojnozi	Nënkryetar Bashkie	Anëtar
- Hazbi Kamberi	Drejtori PPECK	Anëtar
-	Shefi Kom. Dibër	"
- Fatos Gjo ka	Drejtori MZSH	"

- Agron Cara	Drejtor i Shërbimeve Publike “	“
- Mensur Shehu	Drejtori Ekonomik	“
- Ervis Manga	Drejtori Urbanistikës	“
- Ramazan Zili	Drejtori Bujqësisë	“
- Bajram Kalia	Drejtori Doganës Bllatë	“
- Brikena Dani	Zyra Vendore Arsimore	“
- Irini Shehi	Drejtor i Spitalit Peshkopi	“
- Bedri Kamberi	Përgj.Sektorit Ujshjellës Dibër	“
- Majlinda Hoxha	Ëordvizion	“
- Brunilda Lusha	Drejtori Shëndetit Publik	“
- Bardhul Roçi	P.Sekt.Sektorit OSHE Dibër	“
- Kimete Mazari	Kryqi Kuq Dibër	“
- Rafaela Kaloshi	Drejtorja ISKSH	“
- Xhevahir Haka	Përgjegjësi Policisë Bashkiake	“
- Ramazan Tema	Sekretari Komisionit MC	“
- Administratorët	sipas njësave	“

SKENARËT E RREZIKUT

Identifikimi i Riskut

Rreziqe prezente në territorin e Bashkisë

Dibër.

Rreziqet nga dëbora.

Rreziqet nga zjarret.

Rreziqet nga rrëshqitjet e tokës.

Përmbytjet.

Rreziqet sizmike .

Rreziqet nga aktet terroriste.

Rrëziqet nga dëbora:

Është rrëziku periodik vjetor që përfshin Bashkinë e Dibrës.

Bashkia e Dibrës është e vendosur kryesisht në zonën e klimës mesdhetare, paramalore dhe malore, nënzona veriore dhe lindore.

Minimumi absolutë është shënuar në Dibër me 27 janar 1963 ku ka arritur vlerat – 27 gradë C.

Në stinën e dimrit pjesa më e madhe e reshjeve bie në formë dëbore, që fillon nga muaji Tetor, Nëntor deri në fund të muajit Mars.

Trashësia mesatare e arrin nga 80 deri në 1 m, kurse në zonat malore 1000 m mbi nivelin e detit arrin 1.5 deri në 2.5 m.

Për një peri udhë 30 vjeçare veçori janë vitet 1985 me temperaturë absolute -22 gradë C me datë 19 shkurt ku lartësia e borës arriti nga 1.25 deri në 2. m.

Numri mesatar i ditëve me dëborë është 24 ditë. Më shumë zgjat në muajin Janar 10.4 ditë.

Numëri mesatar i ditëve me dëborë shkon nga 40 deri në 100 ditë.

Erërat veriore e verilindore janë karakteristike të periudhës dimërore të cilat përbëjnë 23.6% të gjitha rasteve. Shpejtësia e erës mesatare shkon 11-15 _{ms}

Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5 mm, që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal në zonat që prek, madje pengon operacionet e emergjencës.

Megjithatë, grumbullimi i dëborës rreth 25-50 cm e bllokoi tërësisht qarkullimin e makinave të zakonshme. Në rast se nuk bëhet pastrimi rregullisht prej dëborës, trafiku mund të bëhet vetëm me automjete të posaçme.

Blokimi i popullsisë – rreziku dhe elementët e parapërgatitjes :

Mundësia e bllokimit të popullsisë nga dëborë e llogaritur si popullsi banuese brenda konturit të hapësirës që mbulohet me dëborë me lartësi të paktën 30 cm shkon deri në 51.3% ,në kushtet e klimës më të skajshme. Duke mbajtur parasysh rezervat e ushqimit brenda shtëpive dhe të furnizimeve të tjera si dhe stogjet e tregut në vend , një periudhë bllokimi më e gjatë se 30 ditë duhet të quhet kritike për planifikimin e përgatitjes për emergjencë.

Infrastruktura aktuale ka krijuar fenomenin e frymëmarrjes në qarkullimin e njerëzve ,mjeteve e mallrave duke influencuar drejtëpërsëdrejti në përballimin e emergjencave civile.

Kompanitë kontraktore kanë krijuar një bazë logjistike dhe një performancë të kënaqshme për ndërhyrje.

Rrëzimet nga Zjarret:

Sezoni veror në Bashkinë e Dibrës shoqërohet me temperature të larta ,pasojë e së cilës është fenomeni i zjarreve.Sipas statistikave mesatarisht në vitet, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 kemi patur nga 122-150 raste zjarresh të cilat kanë përshkuar mbi 500- 800 ha me kullota, dushqe, pisha e ah, si pasojë kemi patur edhe zjarreve në një vit 20-25 banesa e në biznese private 5-10 raste me dëme të konsiderueshme ekonomike, ku në disa raste dhe në njerëz.

Problematikë për bashkinë tonë janë zjarret në pyje.

Rreth 70 % e popullsisë së bashkisë Dibër, jetojnë në zona rurale të cilat janë të lidhura me bujqësinë, kryesisht prej veprimtarive të bujqësisë ekstensive dhe blegtorisë. Keqpërdorimi i pyjeve nga njerëzit dhe praktikat e kullotjes, pa dyshim, janë shkaktarët e pjesës më të madhe të shkatërrimit të pyjeve.

Kullotja e pakufizuar dhe zjarret e pakontrolluara, të shkaktuara aksidentalisht dhe shpesh për shkak të djegies me qëllim pastrime kullotash, vijnë të ndodhin në shkallë bashkie.

Dëmet në të korra, të shkurreve e të kullotave dhe humbjet përkatëse, që për një vit arrijnë në miliona lekë, janë humbje të drejtpërdrejta ekonomike.

Gjatë periudhës së stinës së verës sidomos në periudha të thata e me temperatura të larta, zjarret kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në masivet pyjore e kjo sidomos në vitet 2007,2008, 2012, 2016, 2017, 2020.

Në këto vite janë dëmtuar qindra ha pyje nga ato të reja deri në dhjetra vjeçare.

Denduria e zjarreve të pyjeve ndryshon gjeografikisht, duke qenë më e lartë në rrethin e Dibrës Shkaqet kryesore të zjarreve janë pakujdesia e njerëzve, djegia për kullota dhe rritje të hapsirave natyrore. Shumica e dëmeve ndodhin në pyjet halore.

Masat për menaxhimin e zjarreve, që janë përdorur nga strukturat përgjegjëse kanë qenë:

Vënia në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi, vigjilencë për rastet gjatë gjithë periudhës së shtimit të rrëzikut të zjarreve dhe ndërtimi i pritave kundër zjarrit.

Duke u ballafaquar me këtë problem, kaq të mprehtë tashmë ekziston një strategji e mbrojtjes së pyjeve e cila kërkon kontributin e të gjithë strukturave për tu bërë efektive dhe për të arritur rezultatet e pritshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare siç janë pyjet.

Deri tani reagimi e përgjegjësia nga njësitë vendore ka qenë të paktën për Bashkinë e Dibrës e pjesëshme ose në nivele të ulta.

Është koha të mendohet për një sistem unik të përgjigjes ndaj zjarreve si sistemi i vrojtimit e lajmërimit apo evakuimit të popullatës në rrëzik.

Modernizimi i strukturës operacionale si me zjarrfikëse deri në helikopter.

Rrëshqitja e tokës:

Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga rrëshqitjet e tokës :

Bashkia e Dibrës ka si tipar paqëndrueshmëritë masive të tokës, këto lloj fenomenesh gjeodinamike janë pasojë e kombinimit të faktorëve pasiv, ku futet ndërtimi gjeologjik dhe relievi, pjerrësia e madhe e shpateve si dhe e një rrjeti hidrografik të shumtë në të cilën lëvizin ujrat me shpejtësi të madhe.

Më të rrezikshme paraqiten në situatën kur këta shkëmbinj bien në drejtim të shpatit.

Një rol tejet negativ ka luajtur vetë njeriu nëpërmjet shpyllëzimit e formimit të tokave të reja arë.

Sipas llojit të paqëndrueshmërisë së tokës kemi këto veçori në Bashkinë e Dibrës:

Rënia e shkëmbinjëve është karakteristikë e rajoneve malore të Alpeve të Shqipërisë, e shpateve gëlqerore të zbuluara ndaj kushteve të klimës së ftohtë dhe shirave të bollshme në masivin gëlqeror të malit të Korabit.

Shembjet :

Janë karakteristikë për rajonet malore të Bashkisë. Raste të tilla janë shfaqur në njesitë SIlovë të rrethit Dibër.

Rrëshqitjet me zhvendosje :

Rrëshqitjet kryesore janë në zonën tektonike-forciale të Korabit. Fshatrat më të rrezikshme janë SIlovë, Dypjakë, Krej - Reç

Janë mbi 15 objekte banimi të cilat me kalimin e viteve do të kenë probleme të drejtëpërdrejta me këtë fenomen.

Rjedhjet janë fenomene të kufizuara që krijohen kryesisht nga reshjet e shumta.

Erozioni :

Vjen si rezultat i shpyllëzimeve dhe pjerrësi të larta të terrenit, mosfunksionimi i ujrave sipërfaqësore.

Duhet të bëhet një rishikim i plotë në nivel lokal, rajonal në lidhje me situatën e reshjeve, planet dhe veprimet e strukturave si dhe cilësia e operacioneve të ndërmarra në fazën e përballimit.

Rrëziqet nga tërmetet:

Bashkia e Dibrës ashtu si vetë pozicioni i vendit tonë shtrihet në brezin sizmik, alpin-mesdhetar, që përfshin zonën e kontaktit ndërmjet pllakave litosferike të Afrikës e të Euroazisë, e cila shtrihet nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të pellgut të Mesdheut.

Bashkia e Dibrës është shtrirë në zonat e ashtuquajtura "mesatare" për sa i përket intensitetit të tërmeteve. Shkalla e intensitetit është 6 deri në 7 ballë. Origjina e tërmeteve në bashkinë tonë është e karakterit tektonik. Faktorët që ndikojnë në intensitetin e tërmeteve është edhe fortësia e shkëmbinjve. Kemi tre lloje shkëmbinjsh me forcë të lartë mesatare e të ulët. Bashkia e Dibrës ka shkëmbinj me forcë relativisht të lartë dhe të ulët që përfaqësohen nga mbulesat e aluvioneve dhe deluvioneve. Intensiteti i tërmeteve me veprat inxhinierike që janë ndërtuar në shkëmbinj të fortë është më i vogël se në veprat inxhinierike që janë ndërtuar mbi veprat e aluvioneve dhe deluvioneve. Bashkia e Dibrës është goditur nga tërmetet në viete

1967,1979,1998, 2008 e në fundtë vitit 2014, 2018, 2019, ku kryesisht ka patur dëme në objekte ndërtimi.

Vlerësimi i rrezikut nga tërmetet është realizuar për periudha përsëritje 50,100,200,475 dhe 1000 vjet.

Nxitimi maksimal i pritshëm i truallit (NMT-në % të g). $g= 9.81$ cm/s sipas periudhës karakteristike të përsëritjes.

Skenari Burimi sizmik PP-50 PP-100 PP-200 PP-475 PP-1000 max.

Përdorimi i hartës aktuale të zonimit sizmik është përcaktuar për projektimin e ndërtesave të zakonshme. Aktualisht për vepra të rëndësishme dhe objekte të larta është detyrim ligjor të bëhen studime të detajuara inxhiniero –sizmologjike për të nxjerrë të dhëna konkrete në lidhje me rrezikun sizmik për sheshe konkrete ndërtimi.

Nëpërmjet studimit "Vlerësimi i Rreziqeve në Shqipëri" është realizuar për herë të parë vlerësimi tërësor i elementeve të domosdoshme për nevoja planifikimi dhe menaxhimi të emergjencave shkaktuar nga tërmetet.

Rreziku i përmytjeve :

Përmytjet e shkaktuara nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë, shpesh prekin luginat e bashkisë të Dibrës, duke dëmtuar rrjetin rrugor dhe tokat bujqësore. Janë 1 lum ose disa përrenj që përfaqësojnë një rrezik të përhershëm për përmytje. Karakteristika kryesore e tyre është se janë shumë të shpejtë dhe shpesh të "pa besë", sjellin volume të mëdha aluvionesh dhe mund të shkaktojnë dëme të pa parashikueshme në infrastrukturë, objekte banimi dhe bujqësi.

Digat dhe rreziqet :

Ngritja e digave në bashkinë e Dibrës ka nisur pas viteve 60-70'. Digat e para u ndërtuan për qëllime bujqësore. Sot ka 22 sisteme rezervuare me diga. Lartësia e të gjitha digave varion nga 10 m deri në 37 m. Të gjitha digat e larta në bashkinë tonë janë të tipit me mbushje dheu.

Kushtet ekzistuese :

Projektimi dhe ndërtimi i digave mbështetet në një analizë të gjithanshme të të gjithë faktorëve që lidhen me të dhe që prekin sigurinë e vetë digës si dhe të sistemit digë/rezervuar. Për të siguruar kufijtë e sigurisë së projektuar gjatë gjithë periudhës së ekzistencës, rëndësi të dorës së parë ka mirëmbajtja e sistemeve gjatë shfrytëzimit të tyre. Mirëmbajtja e rregullt dhe e frytshme duke përfshirë rehabilitimin në kohën e duhur janë në vecanti thelbësore për sistemet digë/rezervuar ndërtuar me dhe e gurë. Me vjetërimin e digave, siguria e punës së tyre është problem. Kjo kërkon më shumë vëmendje në formën e inspektimeve, vlerësimeve, modifikimeve dhe përmirësimit të digave të vjetëruara, në mënyrë që të përballojnë standartet dhe rregullat e teknologjisë së kohës. Digat në bashkinë e Dibrës prekin një popullsi prej 15000 - 20000 banorësh.

Rrëziqet nga aktet terroriste:

Duhet theksuar se bashkia e Dibrës nuk ka përjetuar ndonjë sulm terrorist dhe në përgjithësi nuk konsiderohet si një vend me rrezik të veçantë për sulmet terroriste. Sidoqoftë ngjarjet e sulmeve terroriste janë rritur, prandaj ky rrezik është prezent.

**GRUPET E PUNËS PËR MONITORIM NDJEKJE E ZBATIM TË DETYRAVE
NË PËRBALLIM TË SITUATAVE TË EMERGJENCËS CIVILE**

Nga administrata e Kryetarit Bashkisë do të krijohen grupet e punës:

Grupi Informacionit

Arse	Avdia	Kordinator	Përgjegjës
Diana	Stojku	Drejtoreshë Informacionit	
Hazbi	Kamberi	Drejtori PPECK	

Grupi i vlersimit:

Ervis Manga	Përgj. Sek. Zhvillimit Urban	Përgjegjës
Edvin Shahi	Sekt. Zhvillimit Urban	
Elona Lusha	Përgj. Sek. Juridik	

Grupi i ndjekjes dhe shpërndarjes së ndihmave:

Ardit Hoxha	Përgj. Sektorit Ndihmës Ekonomike	Përgjegjës
Arsen Avdia	Kordinator	
Antike Torba	Specialiste Finance	

Në bashki kryetar komisioni do të jetë kryetari i bashkisë.

Komisioni EC do të mbledhet çdo ditë në ora 08.00 dhe 14.00.

c. Masat për paralajmërim:

Fenomenet që mund të shkaktojnë emergjencë në bashkinë e Dibrës janë rreshjet e mëdhatë dëborës, temperaturat e ulëta, suferinat.

Vëzhgimi do të bëhet nga Kryetarët e fshatrave e personeli i gadishmërisë së institucioneve.

Paralajmërimi i hershëm bëhet nga shërbimi sinoptik i vendosur në Peshkopi.

Nga qendra sinoptike do të bëhet njoftimi i kryetarit e zv.kryetarit të Komisionit të Emergjencës Civile.

VI. Komunikimet:

Mënyra e komunikimit midis niveleve të ndryshme do të bëhet me telefon kabllor e mobil.

Do të shfrytëzohet ndërlidhja me radio nga Komisariatet.

Gjithashtu do të shfrytëzohet ndërlidhja me strukturën e MZSH-së.

Komunikimi me mediat do të bëhet me komunikatat e shtypit të zëdhënësit të komisionit si dhe të konferencës të shtypit të organizuar nga kryetari.

VII. EVAKUIMI DHE SHPËTIMI.

Në rastet e krijimit të fatkeqësive nga orteqet apo rrëshqitjet e tokës e cila shoqërohet me pasoja në njerëz do të veprohet nga kjo strukturë operacionale.

Drejtues operacioni :

Shefi i MZSH-së

MZSH-ja.

Policia e Shtetit

Policia Pyjore

Shërbimi i Ambulancës

Kryqi i Kuq

VIII. EMERGJENCA SHËNDETËSORE

Drejtoria e Shëndetit Publik do të përballojë nëpërmjet infrastrukturës së këtij shërbimi në Bashkinë e Dibrës 17 Q.SH,

Po në funksion të kësaj veprimtarie do të jenë 9 ambulanca nga të cilat 9 në Dibër,

Do të veprojnë repartet e Urgjencës Dibër,

Ndërhyrjet kirurgjikale do të bëhen në repartet kirurgjikale të spitalit Dibër.

IX. PUNIMET URGJENTE PËR RIPARIMIN E MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE PUBLIKE.

Ndërhyrjet më emergjente që duhet të bëhen në infrastrukturën rrugore janë:

a. Sistemitimi e rehabilitimi i rrugëve nacionale.

Rruga e Rinisë, nga Muhurr-Reç.

b. Rrugët rurale:

Arras-Lurë

Muhurr-Selishtë

Muhurr - Reç

X. VLERËSIMI :

Komisioni i vlerësimit në shkallë Bashkie do të jetë:

Ervis Manga

Përgj. Sek.Zhvillimit Urban

Përgjegjës

Edvin Shahi

Sekt. Zhvillimit Urban

Elona Lusha

Përgj.Sek.Juridik

Antike Torba

Specialiste Finance

Nga organet vendore krijohen komisionet e vlerësimit në shkallë Bashkie/Njësi Administrative.

XI. DËRGIMI DHE SHPËRNDARJA E NDIHMAVE:

Magazinimi:

Magazinimi i mallrave do të bëhet kryesisht në qendrën e qytetit Peshkopi.
Nga biznesi privat mbahen në magazinat e tyre.
Artikuj ushqimore e jo ushqimore do të grumbullohen në të njëjtat magazina.

Shpërndarja:

Shpërndarja e artikujve ushqimor e jo ushqimor do të bëhet nën drejtimin e grupeve të shpërndarjes së ndihmave.

Shpërndarja do të bëhet nga Bashkia.

Nga Bashkia do të bëhet shpërndarja e drejtpërdrejtë në Nj. Adm. e kjo e fundit nëpërfshatrat nëpërmjet kryetarëve të fshatrave.

Vëzhgimi:

Do të bëhet nga anëtarët e Komisionit EC të Bashkisë.

Për çdo dërgesë do të ketë përfaqësues të bashkisë.

Raportimi:

Raportimi do të bëhet nga administratorët e Njësive Administrative e kryetari bashkisë. Për problemet e dala njoftohet menjëherë Kryetari i Komisionit EC të Bashkisë.

XII. VENDET E PËRKOHSHME PËR STREHIM :

Për strehim do të përdoren godinat e ish reparteve ushtarake.

Hoteleritë në qytete apo edhe godinat në disa shkolla në fshatra.

Shtëpitë e braktisura si rezultat i lëvizjes së popullsisë në drejtim të qendrave urbane.

XIII. SHËNDETI PUBLIK:

Do të jetë në vëmendjen e të gjithë këtyre institucioneve që lidhen me këto shërbime.

Ushqimet do të mbahen nën kontrollin e vazhdueshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Ushqimit.

Uji i pijshëm do të jetë nën mbykqyrjen e vazhdueshme të epidemiologëve dhe punonjësve të tjerë të ujësjellësave.

Higjiena publike do të ndiqet nga Drejtoria e Shëndetit Publik, duke ndjekur gjatë gjithë kohës gjendjen e shëndetit të popullatës.

XIV. RUAJTJA E RENDIT PUBLIK E QETËSISË PUBLIKE.

Nga Komisariati Vendor i Policisë në Bashki në zbatim të Ligjit "Për Policinë e Shtetit" me Plane Veprimi do të mbajnë rendin e qetësinë publike.

Gjatë gjithë kohës do të bashkëveprohet me Kryetarin e Komisionit të Emergjencave Civile të bashkisë, për problemet e dala dhe masat që do të merren për eliminimi e tyre.

Automjete të Policisë do të shërbejnë për t'u ardhur në ndihme popullatës në nevojë.

Punonjës Policie për menaxhimin dhe përballimin e këtyre situatave janë gjithsej 20.

Në qytet do të veprojnë forcat e specializuara e të gadishmërisë.

Në njësitë administrative inspektorët e zonave dhe policia bashkiake.

Në rastet e fatkeqësive nga Komisariati Vendore i Policisë do të bëhet izolimi i zonës e marrjes pjesë drejtëpërsëdrejti në operacionet e shpëtimit.

Policia Vendore e Kufirit dhe Migracionit ka në dispozicion mjete dhe punonjës policie.

XV.NEVOJAT PËR BAZË MATERIALE, KOSTOJA DHE PREVENTIVI.

Për përballimin e Emergjencave Civile Dimërore në bashkinë e Dibrës janë këto nevoja:

Nevojat për furnizim me mallra ushqimore të popullatës së bashkisë për periudhën

Imujore janë:

Rrethi i Dibrës 1130 ton.

Për organet vendore është i domosdoshëm e disponibël fondi financiar në Zërin e Emergjencave Civile në masën 4%.

Për vetë kushtet e vështira malore për shërbimin shëndetësor nevojiten 3 autoambulanca 4x4.

Për ujësjellësat nevojitet një fond prej 12 milion lekë.

Në rezevat e shtetit është e domosdoshme krijimi i mallrave stoqe për ndihmë të menjëherëshme.

Elementët e ekspozuar :

Përdorimi i indikatorëve sasiore.

4.SISTEMI I ALARMIT

Sistemi Shqiptar i paralajmërimit të hershëm.

- Igjeum
- Shërbimi metrologjik ushtarak- MM
- Mjetet, pajisjet, procedurat dhe instrumentet.
- Përshkrimi i buletinit dhe i kodeve të ngjyrave

Akti vitetet monitoruese në kohë reale.

Procedurat e monitorimit.


Monitorimi i të dhënave.

5.MODELI I NDËRHJRJES

Organizimi brenda Bashkisë.

Qendrat Kordinuese

- Komisionet kombëtare, të Prefekturës dhe të Bashkive .



Kriteret e identifikimit të Qendrave të Koordinimit/ Komisionit (Nr.Referencës nëse është i pranishëm)

- Aktivizimi dhe përbërja e Komisionit të PPECF

Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive në Nivel Bashkie.

Në bazë të ligjit Nr. 45, dt. 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, me Urdhër Nr. 280 datë 25. 05. 2022 të Kryetarit të Bashkisë është krijuar dhe funksionon *Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Nivel Bashkie*, i cili ka në përbërje:

- Rahim Spahiu	Kryetari Bashkisë	Kryetar
- Ruzhdi Deda	Nënkryetar Bashkie	Zv. Kryetar
- Sajmir Kojnozi	Nënkryetar Bashkie	Anëtar
- Hazbi Kamberi	Drejtori PPECK	Anëtar
-	Shefi Kom. Dibër	“
- Fatos Gjoka	Drejtori MZSH	“
- Agron Cara	Drejtor i Shërbimeve Publike “	“
- Mensur Shehu	Drejtori Ekonomik	“
- Ervis Manga	Drejtori Urbanistikës	“
- Ramazan Zili	Drejtori Bujqësisë	“
- Bajram Kalia	Drejtori Doganës Bllatë	“
- Brikena Dani	Zyra Vendore Arsimore	“

- Irini Shehi	Drejtor i Spitalit Peshkopi	“
- Bedri Kamberi	Përgj.Sektorit Ujssjellës Dibër	“
- Majlinda Hoxha	Ëordvizion	“
- Brunilda Lusha	Drejtori Shëndetit Publik	“
- Bardhul Roçi	P.Sekt.Sektorit OSHE Dibër	“
- Kimete Mazari	Kryqi Kuq Dibër	“
- Rafaela Kaloshi	Drejtorja ISKSH	“
- Xhevahir Haka	Përgjegjësi Policisë Bashkiake	“
- Ramazan Tema	Sekretari Komisionit MC	“
- Administratorët sipas njësive		

Detyrat dhe mënyrat e funksionimit të Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave civile në nivel Bashkie janë:

- Komisioni i planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile i cili planifikon, koordinon dhe kontrollon të gjitha masat parandaluese, lehtësuese, dhe rehabilituese për përballimin emergjencave civile në qark.
- Komisioni jep informacion pranë Qendrës Kombëtare të Emergjencave Civile në situatë emergjente dhe ngarkon sekretarin për të dërguar informacion në periudhë normale.
- Komisioni bën përpunimin e të gjithë të dhënave për resurset që ka në territor, bazën materialo – teknike nën administrimin shtetëror e privat dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në situatë emergjente .
- Komisioni përgatit dhe përpunon programe trajnimi, skenare për emergjencat civile për komunitetin.
- Komisioni mbështet drejtuesit e operacionit në nivel bashkie për menaxhimin e emergjencave civile.
- Komisioni bashkërendon veprimtari në organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në raste emergjence.
- Në rast krizash, Komisioni i PPECF bashkëpunon me Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe koordinon veprimet me të gjitha institucionet shtetërore qendrore në nivel rajonal, organet e qeverisjes vendore, subjektet private dhe OJQ për normalizimin e situatës. Krizat mund të jenë të llojeve të ndryshme si:
Për pritjen e refugjatëve, krizë e shkaktuar nga tërmete, përmytje, nga lufta etj. Në rast se kriza është e pritshme, atëherë është më e lehtë për t'i paraprirë situatës, duke ngritur kampet me të gjitha kushtet hidro-sanitare dhe duke siguruar furnizimin me ushqime, ujë të pijshëm, veshmbathje, ngritjen e Qendrave Shëndetësore etj.
- Komisioni bashkëpunon me Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe me institucione të tjera për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera, si dhe në riaftësimin e zonave të dëmtuara.

Funksionimi komisionit :

- Komisioni funksionon në situata normale dhe situatë emergjente.
- Komisioni mbledhet një herë në tre muaj për situata normale dhe çdo ditë në situatë emergjente.
- Komisioni në mbledhjen e parë përcakton veprimtarinë e punës së tij dhe harton rregulloren e funksionimit të komisionit.
- Sekretari i komisionit mban përgjegjësi për përgatitjen e materialeve dhe aktiviteteve të komisionit.
- Për zbatimin e këtij urdhëri përgjigjet sekretari i komisionit.
- Ky urdhër hyn në fuqi nga data e daljes së tij.

- Hartëzimi i Qendrave Koordinuese / Komisionit

Zonat e emergjencës

- Kriteret Kombëtare të identifikimit të zonave të Emergjencës
- Hartëzimi i zonave të Emergjencës: xxxxxxxx
Mjetet e Brendëshme dhe të Jashtme
- Llogjistika


Kapacitetet e Bashkisë Dibër për Menaxhimin Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive.

Gjendja e burimeve njerëzore dhe logjistike aktuale në Bashki, në sektorin publik dhe privat që mund të angazhohen në raste emergjence për sezonin vjeshtë-dimër Bashkia Dibër.


QARKU DIBËR	Burime njerëzore dhe logjistike											
	Personel	Ekspertore	Fadroma	Vinca	Makina gjërmimi dhe transporti të llojeve të ndryshme	Mjete zjarrfikëse	Borë pastuese	Varka/skate	Pompa tërthëse uji	Antoambulanca	Laborator për kryerje analizash ushqimi dhe uji të pishëm	Numri i shpirtërive për evakuim, spitale, mjete, korrivjete për evakuim (sipër m2)
Emërtimi i subjekteve publike, private dhe organizatave të ndryshme.												
Shërbimi Spitalor	353								9	2	50	
Elektriku	66				2							
Ujësjiellësi	65		1					1				
Rrugët Nacionale	3											
Sub Priv për Rrugët	1	15	9	2			16					
MZSH	21					2						
Organet vendore	184	2	9	1	13		3				1460	6
Dr. Policisë Qarkut	76											

Skema e lajmërimit të drejtuesve të Qeverisjes Vendore Bashki Dibër

Skema e sistemit të lajmërimit, Nr.tel si pika kontakti të shërbimit të gadishmërisë 24 orëshe.



Skema e sistemit të lajmërimit, nr tel dhe të dhënat tjera të anëtarëve të Komisionit të Emergjencës Civil në nivelin e Bashkisë.



Përshkrimi i modelit të ndërhyrjes.

Mënyra e aktivizimit të Qendrës së Koordinimit/ ose Komisionit në parashikim dhe në përgjigje

Aktivizimi i funksioneve operacionale

Srukturat monitoruese :

Struktura monitoruese në bashki janë: Salla Operative e Policisë së Shtetit, Shërbimi Zjarrfikës, Srukturat e EC në bashki, nëpunësit me funksion të dytë për EC në administratën e njësisë vendore, stacioni hidrometeorologjik, sizmik.

Strukturat vepruese aktive :

Strukturat kryesore aktive ose forcat operacionale janë:

Forcat Vepruese Aktive (Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Dibër, SHMZSH, Shërbimi Ambulator, Shërbimi Spitalor të cilat kryejnë funksionet e tyre në parandalimin dhe përbalimin e emergjencave

civile. Këto struktura janë forca të shërbimit të mbrojtjes civile në varësi të bashkisë. Gjithashtu pjesë e strukturave të EC vepruese është edhe vetë komuniteti.

Strukturat mbështetëse :

Struktura mbështetëse në bashki janë:

Inspektoriat Shtetëror i Pyjeve, Mjedisit dhe Ujrave, Drejtoria Rajonale e Bordit të Kullimit Durrës, OSHEE, OST, Nj.T.L, Sektori i Ekstensionit Bujqësor, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Zyra Vendore të Arsimit, Rajoni Qendror për Rrugët Nacionale Shkodër, Drejtoria Rajonale e Rezevave Materiale të Shtetit, Agjensia Rajonale e Mjedisit, Grupet vullnetare, KKSH, Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave ,OJF-të.

Etapat për aktivizimin e SSHECQ :

Nëpërmjet etapave të aktivizimit të sistemit sigurohet përdorimi i kapaciteteve në mënyrë të përshtatshme për të gjitha llojet e emergjencave edhe pse, sipas situatave mundë të mos kalohet në të gjitha etapat. Në rastin e një ngjarje të papritur, të menjëherëshme, aktivizimi i sistemit fillon menjëherë direkt me etapën

3 “aktivizimi”. Në çdo rast, nëse merret informacion paralajmërues, për të siguruar parapërgatitjen optimale, shfrytëzimin në maksimum të burimeve dhe bashkërendimin në mënyrën me të mirë të mundëshme dhe të përgjigjes në shkallë rajonale dhe kombëtare ndaj emergjencës, ndiqen katër etapat e mëposhtme:

Etapa 1: “Alarm për rritjen e gadishmërisë” kryetari bashkisë në çastin e marrjes së njoftimit paraprak ose informacionit të mundësisë së ndodhjes të një ngjarje(e cila mund të shoqërohet me dëmtime në njerëz dhe dëme materiale.)

Prefekti i Qarkut :		Kontrolli i relizimit të aktivitetit
ETAPA 1: “ALARM PËR RRIJTJEN E GADISHMËRISË”		
1	Në Bashki ngrihet Zyra e Informacionit dhe Menaxhimit të EC në territorin Bashkisë përkatëse.	
2	Informon Ministrinë e Mbrojtjes, Prefektin për kalimin në gjendje “Alarmi për rritjen e gadishmërisë”.	
3	Komunikon me zyrat e EC-së dhe drejtuesit e organeve të pushtetit vendor	
4	Informon të gjithë institucionet dhe strukturat e duhura.	
5	Informon institutet shkencore dhe kërkon prej tyre dhënie të informacionit të vazhdueshëm dhe parashikimin për zhvillimin e situatës	
6	Jep urdhërin për funksionimin e QOQ, verifikimin e stafit të mjaftueshëm dhe të paisur për punë 24 orë gjatë etapës “Alarm për rritjen e gadishmërisë”.	
7	Në QOQ-në, kontrollon mjetet e komunikimit, numrat e telefonave celulare, radion, llambat e ndriçimit dhe siguron që telefonat të jenë të ngarkuar. Vendos në dispozicion numrat shtesë telefonik të institucionit dhe njoftohet personeli (operatorët e komunikimit) për situatën.	
8	Verifikon që mjetet e transportit të institucionit të jenë në gadishmëri të pajisura me mjetet e nevojshme, karburant dhe kanë rezerve karburanti. Për plotësimin e nevojave nxjerr urdhër për venien në dispozicion të 1-2 mjeteve të institucioneve të tjera.	
9	Kerkon DRSH-të Mat konfirmimin e nivelit të stokut, gjendjen dhe vendndodhjen.	

10	Siguron informacion të saktë për të bërë paralajmerimet dhe këshillimet e duhura përpublikun me anë të mjeteve të informimit. Për këtë cakton zëdhënësin për komunikimin me shtypin dhe jep udhëzime për këtë qëllim.	
11	Përgatit informacion të përmbledhur për MM, Qeverinë dhe degën e Kryqit të Kuq.	

Etapa II : Vendosja e Gjendjes së Gadishmërisë :

Bëhet kur një ngjarje e afërt konsiderohet e pashmangshme dhe që mund të shoqërohet me dëme në njerëz dhe materiale.

Kryetari bashkisë: ETAPA 2: VENDOSJA E GJENDJES SË GADISHMERISË	Kontrolli realizimit te aktivitetit
1. Informon Prefektin dhe Ministrin e MM rreth situatës dhe nevojës për fillimin e etapës 2 “Vendosja e Gjendjes së Gadishmërisë” i cili vendos për fillimin e kësaj etape.	
2. Mbledh Komisionin e Emergjencave Civile dhe grupin e specialistëve si dhe kërkon përgatitjen për procesin e marrjes së vendimeve, takimeve informative për median dhe partenerët.	
3. Komunikon (Zyra e EC dhe QOQ) me drejtuesit vendor (Punonjësin e Emergjencave Civile), duke kërkuar mbledhjen e KVEC-së dhe ndjekjen e situatës sipas planeve të emergjencës.	
4. Informon të gjithë institucionet dhe strukturat e duhura, veçanërisht ato që përfshihen në përgjigjen e parë (njoftimi paraprak/informimi i publikut, evakuimi, kërkimshpëtimi, ndihma e parë, zjarrfikësit dhe siguri i vendeve të strehimit të përkohshëm).	
5. Komunikon me institucionet, strukturat monitoruese dhe kërkon prej tyre dhënien e informacionit të vazhdueshëm për parashikimin e situatës, informacion i cili dërgohet në mënyrë të menjëherëshme Prefektit dhe Ministrin të Mbrojtjes.	
6. QOQEC siguron dërgimin urgjent të të gjithë të dhënave dhe parashikimeve të ardhura nga QKOEK Punonjësve të Emergjencave Civile dhe anasjelltas në QKOEK.	
7. Zyra e EC-së (QOQEC) harton Raportin e Parë të Situatës dhe informacioneve të rezervuara për Prefektin i cili sipas rastit i dërgohet Ministrin të Mbrojtjes ose Kryeministrin. Përmbledhja e raportit që vjen nga lart mundë të qarkullohet si informacion i rezervuar tek disa drejtues, sipas vlerësimit të Prefektit.	
8. Kontrollon dhe siguron që të gjithë masat e mëparshme janë përmbushur. QOQEC-ja punon me staf të plotë, të pajisur për të punuar në Etapën e Gadishmërisë për 24 orë.	

9. Krijon një Grup të Përbashkët Vlerësimi për në zonat e prekura nga fatkeqësia, verifikimin e të dhënave për situatën dhe në mbështetje të strukturave të emergjencave civile.	
10. (Zyra e EC dhe QOQEC) përgatit materiale paraprake mbi dëmet, nevojat e pritëshme dhe forcat operacionale që mundë të përfshihen për përballimin e emergjencave, nisur nga informacionet, për zonën, natyrën e fatkeqësisë, vlerësimi i rreziqeve, etj.	
11. Përgatit (zëdhënësi) informacione për publikun, median dhe raporte periodike për instancat qeveritare, donatorët, KKSH dhe OJF-të e interesuara.	

Etapa III: Aktivizimi fillon në rastet kur një ngjarje e papritur ka shkaktuar dëmtime në njerëz dhe materiale, ose kur një ngjarje e ngadaltë është në zhvillim e sipër dhe mundë të sjellë të njejtat pasoja të cilat tejkalojnë mundësitë për t'u përballuar nga strukturat e SHEC-së.

Ministri i Mbrojtjes është autoriteti që njofton fillimin e etapës 3 "aktivizimi", duke angazhuar strukturat e përherëshme që në misionin e tyre kanë detyra për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile. Në rast se emergjenca është e përmasave të mëdha dhe është shpallur gjendja e emergjencave civile në mbledhjen e parë të KPPEC, prefekti emëron drejtuesin e operacionit në nivel qarku i cili do të marrë drejtimin përgjigjen në nivel qarku dhe ndihmën kombëtare, nëse është e nevojshme.

ETAPA 3. AKTIVIZIMI	Kontrolli i
Për emergjenca të shkallës së ulët : kryetari bashkisë :	përfundimit të aktivitetit
1. Sigurohet për aktivizimin e strukturave dhe kapaciteteve të përgjigjes në nivel bashkie duke përfshirë dhe venien në funksion të KVEC-ve të njësisve vendore dhe informon Prefektin dhe Ministrinë e Mbrojtjes.	
2. (Zyra EC, QOQEC) kërkon informacion nga drejtuesit e bashkive/njësive administrative.	
3. Qendron në kontakt me institucionet qendrore dhe donatorët brenda vendit, për sigurimin e mundësive të mbështetjes.	
4. Kërkon aktivizimin e menjëhershëm të gjithë institucioneve dhe strukturave operacionale.	
5. Nëse është e nevojshme, i kërkon Prefektit, Ministrit të Mbrojtjes, ose Kryeministrit të deklarojë gjendjen e Emergjencës Civile për zonën e përfshirë.	
6. Nëse nuk është bërë ende, krijon Grupe të Përbashkëta Vlerësimi për t'u dërguar në zonat e prekura nga fatkeqësia, për verifikimin e të dhënave të situatës dhe mbështetjen e autoriteteve vendore.	